

FATMIR MINGULI

TRIPTIK HISTORIK

NIVICË – BUBAR

1544-1659

Një shikim mbi figurat Gjergj Basta, Neofit Rodino dhe Mexsi Buba



-2016 -

- Triptik Historik -
Nivicë - Bubar
(1544-1659)

Autori
Fatmir Minguli

Redaktor
Piro Minguli

Art Grafik & Kopertina
Studio 2M Printing

Botues
2M Printing

ISBN 978-9928-1227-5-9

© Autori

STUDIO 2M PRINTING
Shtëpi Botuese, Studio Grafike,
Shtypshkronjë
www.2mprinting.al / studio.2mprinting@gmail.com
+355 67 60 27 887

Falenderim

Për realizimin librit “Triptik Historik” më duhet të bëj disa falenderime të gjithë atyre shokëve, miqve, specialistëve e shumë njerëzve të tjerë të cilët jo vetëm ndihmuan në botimin e tij, por në një farë mënyre janë pjesë përbërëse virtuale e librit.

Falenderimi i parë shkon për të gjithë bashkëfshatarët e mi niviciotë, të cilët janë vetë pasardhësit e dhjetra brezave e që ndër shekuj luftuan, punuan dhe ndërtuan histori të veçantë në Bregdetin e Poshtëm.

Falenderoj në mënyrë të veçantë z. Vladimir Kumi, kryetarin e Komunës së Lukovës, i cili ndihmoi jo vetëm materialisht, por ndriçoi një seri problemesh historike që lidhen me temat e këtij libri. Atij i takon merita e gjetjes të shumë dokumentave të ndryshëm mbi tre figurat historike, sidomos për misionarin bazilian Neofit Rodino, figura që lidhen me fshatin Nivicë- Bubar. Gjithashtu e falenderoj për kurajon, gjë që e karakterizon gjithmonë, për diskutimet dhe vrejtitet me vlera gjatë hartimit të librit “ Triptik historik ”.

Falenderoj vëllanë tim Piro Minguli për vrejtitet e ndryshme gjatë strukturimit, vërejtje të cilat e sollën atë në pamjen e duhur jo vetëm si një libër thjeshtë historik.

Falenderoj zotërinjtë Petraç Pali, Agim Mato, Vaso Dhimërtika , Vladimir Muça, Luan Çipi, Sokol Luarasi, Harrillaq Maça, Vasil Zhupa etj, të cilët më kanë ndihmuar me vrejtitet e me materiale studimore, që më kanë nxitur për ta realizuar sa më mirë këtë libër për fshatin tim, Nivicë- Bubar. Kujtoj këtu dhe shëvasjotin, të ndjerin Thoma Zhupa i cili më dha të gjithë njohuritë e tij për shumë histori dhe fakte të ndryshme.

Falenderoj Dr. Moikom Zeqon, librat e të cilit për Himarën dhe studimet e tij të ndryshme për Bregdetin kanë qenë një ndihmë tepër e çmuar.

Falenderoj zotin Pëllumb Xhufi për vënjen në dispozicion të studimeve të tij si dhe për angazhimin e tij si historian i respektuar në studimin e problemeve historike të Bregdetit në përgjithësi.

Falenderoj të ndjerin Minella Gjoni i cili më konsultoi jo vetëm me librat e tij plot vlerë.

Falenderoj të gjithë studion FPF (Film Production Papadhimitri) producente e dokumentarit filmik për Bregdetin e Poshtëm, e cila pasqyron shumë fakte që më kanë orientuar gjatë hartimit të këtij libri.

Falenderoj arkitektin Gentian Mëhilli puna e të cilit ecën paralel edhe me jetën e këtij libri tim, por dhe për ndihmën e tij, duke më dhënë një seri dokumentesh që kanë të bëjnë me strukturën e “ Triptikut Historik ”.

Falenderoj zotërinjtë Josif Papagjoni dhe Miho Gjini të cilët si drejtues të botimit të antologjisë “ Shtigjeve të vendlindjes” me krijues të Bregdetit në gjashtë vëllimet 1, 2, 3, dhe 4, 5, 6 kanë bërë të mundur pasqyrimin e veprave të ndryshme të shkrimtarëve, poetëve dhe studjuesve të fshatrave Nivicë- Bubar, Shën Vasil, Lukovë, Sasaj, Piqerras, Borsh, Ftterrë, Çorraj dhe duke më dhënë jo vetëm frymëzim por dhe të dhëna të ndryshme shumë të dobishme. (Vepra “Shtigjeve të vendlindjes” është mundësuar nga Komuna e Lukovës.)

Falenderoj të gjithë krijuesit e Bregdetit të Poshtëm, pjesmarrës apo jo në këto Antologji, që jetojnë në Shqipëri apo në Greqi a gjetkë, librat e të cilëve janë gurë të çmuar në kalanë e së vërtetës së fshatrave tona, fshatra ku malet janë martuar me detin.

Autori



Gjiri i Kakomesë

PARAFJALË

Rindërtimi i Kujtesës është restaurimi i shekujve - kjo ka të bëjë me hulumtimin shkencor të mirëfilltë, ka të bëjë me pasionin e çuditshëm të dijës dhe me një etikë të veçantë të vetëdijes - pra shkenca plenohet, ngjizet nga një vizion moral!

Kjo spjeron si lind, si konstruktohet një libër!

Libri i studiuesit të thukët dhe të ditur, mikut tim të vjetër Fatmir Minguli i ka këto përmasa në substancë, në ndjeshmëri dhe në shpalosje të koncepteve, ideve dhe të të dhënave, në parashtrim dhe në shtjellimin subjektor.

Struktura kryesore dhe e patjetërsueshme e Kujtesës është gjeografia - kordinatat e saj nuk lëvizin – në librin e Mingulit treva jugore e Nivicë -Bubarit është shtrati i historisë njerëzore. Nivicë -Bubari është jo vetëm vendëllindja, origjina, por dhe shpirtëzimi i figurave dhe bëmave historike në kohëra.

Libri i Mingulit quhet “TRIPTIK HISTORIK – NIVICE - BUBAR, 1544-1659” dhe fokusohet sidomos në lartësimin e tri figurave kryesore: Gjergj Basta, Neofit Rodino dhe Mexsi Buba që zotërojnë në harkun e dy shekujve XVI-XVII.

Këto figura të iluminuara shqiptare i takojnë kulturës - ky është procesi i galvanizimit të tyre në Kujtesë – plotëfuqishmëria e ndikimit dhe mos-harresës!

Gjergj Basta si Gjeneralisimus është edhe autor i librave teorikë të strategjisë ushtarake në rrafshin europian, dy të tjerët gjithashtu janë mjeshtra të shkrimit- të tre janë të ndryshëm për të arritur në një unitet, janë më vehte për të qenë bashkë - ky është edhe synimi dhe ngulmimi i librit në fjalë.

Treva e Nivicë-Bubarit është gati magjike - mrekullia joni-ke e Jugut i ka mbështjellë brigjet, Gjirin e papërsëritshëm të Ka-

komesë, manastiret dhe kishat me paqen e tyre biblike, ku erërat thonë psalmet e bekuara të amëshimit, në ullinjtë, kaktueset dhe agaviet, shtëpitë, kalldrëmet, ku traditat familjare krijojnë gjenealogji interesante me kodin e mbijetesës dhe të krenarisë së denjë. Pa harruar asnjëherë detin – ah, detin deradian, detin pa një të dytë në botë!

Fatmir Minguli e ka këtë libër mozaikun e vet intim, e ka shkruar me pasionin e shpalosjes së një afresku onufrian - por në thelb këtë e bën për të tjerët, për gjeneratat.

Ky autor ka sharmin e një intelektualit të talentuar dhe të kulturuar në shumë plane – shkencëtar i mekanikës, i paneleve diellore, veprimtar i shquar publik, i pedagogjisë universitare, eseist i pazakontë, kritik letrar i veçantë, - Fatmir Minguli e ka këtë libër mes koleksionit të librave dhe shkrimeve të tij si diçka testamentele, të shenjtë, të frymëzuar, me një dashuri të sprovuar dhe intimitet të një ndjeshmërie të lartë.

E uroj me gjithë shpirt mikun tim të nderuar, Fatmirin për këtë libër të bukur dhe të domosdoshëm- për punën dhe dimensionin e tij kulturologjik kaq tërheqës!

Libri me referencat, ikonografinë e ilustrimeve është pady-



Motiv shekullor i bregdetit të Jugut

shim lapidariumi i Kujtesës së vendëllindjes, origjinës, krejt i natyrshëm me rrënjët në tokën jugore, si një binjakëri shkrimore e rrapit legjendar të Nivicë -Bubarit!

Dr. MOIKOM ZEQQ
Tiranë, 20 korrik 2014

PJESA E PARË

Pranë Shën Vasilit, 2 kilometra larg tij, ndodhet fshati i bukur i Nivicës me rrapin shekullor dhe sheshin e kapedanëve ku çlodhen pleqtë e Nivicës. Kisha e Shën Dhimitrit e sapondërtuar dhe këmbanarja pranë saj bëjnë përshtypje të madh. Rrugicat e ngushta midis banesave kulla çojnë drejt pyllit me gjelbërim të përhershëm...

Jano Koçi, në librin “Himara”

Ka mote e mote që nuk pushon ajo kënga për pleqtë me
mend që mblidhen nën rrapin e Nivicë Bubarit.
Zgjatën degët e mëdha në shpatet thikë të Shëndëlliut
të thepisur
zgjatet isoja dhe mbajnë frymën shenjtorët në kishat
e manastiret rreth e rrotull,

Agim Mato, nga poezia “ Nivicë Bubari ”
në librin ‘Lundrimet’, f.99

Deti përballë sikur të fton edhe sot në aventurën e kahershme të Odisesë, Uliksit, i cili, vetë pas Trojës , pat qëndruar diku aty te magjiplota Çirçe. Sipër Himarës, në krye, Akrokeraunet (Mali i Vetëtimës), nga ku Zeusi qëllonte më rrufe, poshtë, në fund, ku krahina çplodh shputat e këmbëve, Nivicë- Bubari , vendi mendimtar i trimave, fshehur pas shpatullave të detit, e tret vështrimin tutje, nga fusha dhe shtigjet prej ku shkante e vinte, jepte e merrte, por edhe shquante, si nga karakolli, taboret armike, që vinin herë tinëz e herë me tupanë e bori...

Josif Papagjoni

Në librin e parë të krijuesve të bregdetit :
”Shtegut të vendlindjes”, f.

NË VEND TË HYRJES

“ Nga ana tjetër edhe shqiptarët që mbetën të krishterë, nuk ndjenin asnjë lidhje të posaçme me grekët, megjithëse kishin të njëjtin besim fetar.”¹

Kjo shprehje është marrë nga libri i studjueses Katherinë E. Fleming “ Bonaparti mysliman” dhe më mirë se kushdo jep faktin që veçanarisht fshatrat bregdetas Nivicë-Bubar dhe Shën Vasil jo vetëm që nuk e kthyen fenë që nga viti 1670 në gjithë tokat shqiptare e deri te sulmet gjakatare të Ali Pashë Tepelenë në vitin 1797, por mbetën përjetësisht krenarë për autonominë e tyre jo vetëm religjioze. Po në këtë libër theksohet dhe një fakt që vertëton indirekt se si këto dy fshatra të Breg detit të Poshtëm ishin në pozita të vazhdueshme kundër jo vetëm Ali pashë Tepelënës por kundër gjithë perandorisë osmane. “Aliu , i cili në fakt po sulmonte territore që i përkisnin një homologu të emëruar gjithashtu nga Stambolli (Mustafa pashë Delvina-F.M.), mundi të justifikonte sjelljen përpara Portës duke pohuar se shumë nga fshatrat që po sulmonte, konkretisht Nivicë –Buba dhe Ajo –Vasilin, ishin të populluara nga të krishterë, të cilëve në të shkuarën venedikasit u kishin garantuar një lloj autonomie e që tani rrezikonin të ngriheshin kundër Perandorisë.”²

Siç shihet vetëm nga këto dy paragrafe në librin e kësaj studjueseje dalin një serë konkluzionesh që kanë të bëjnë me fshatin e Bregdetit, Nivicë-Bubarin. Konkluzionet që do të trajtohen hollësisht në këtë studim kanë të bëjnë me ngjarje dhe persona të rëndësishëm të periudhave që vinë fill mbas vdekjes së Skënderbeut.

¹ Katherine.E.Fleming, “Bonaparti Mysliman”- Diplomacia dhe Orientalizmi në Greqinë e Ali Pashës -Tiranë, Dituria 2003, f.86

² po aty f.12

Ngjarjet dhe personat që trajtohen janë realë, me dokumenta që ekzistojnë në rrang europian. Ngjarjet janë të shkëputura nga njëra tjetra, personat janë të shkëputur nga njëri tjetri, por janë brenda një qerthulli jo vetëm kohor por dhe të problemeve sociale si ato ekonomike, kulturele, të religjionit, të kultivimit të gjuhës shqipe, të ndërtimit të shkollave shqipe, të luftës kundër perandorisë osmane, të mardhënieve tregtare etj. Bregu i Salentos përballë brigjeve jugore të Shqipërisë ishte pjesa tjetër pritëse e urës së vazhdueshme të lëvizjes së bregdetasve jo vetëm nga Nivicë –Bubari .

Fshati Nivicë Bubar është origjina e gjeneralit të madh dhe teoricienit ushtarak Gjergj Basta; në Nivicë –Bubar misionari bazilian, Neofit Rodino ndër të parët misionarët e Romës, vepronte dhe shkruante libra , pikërisht në shkollën e këtij fshati; Meksi Buba, prej fshatit Nivicë-Bubar ishte : ”mëkëmbës i përgjithshëm i provincës së Epirit ” dhe kryesonte delegacione për marëveshje tregtare dhe juridike në Italinë e Jugut e kështu me rradhë.

Besoj se nuk janë pak fakte të tilla të ndodhura në një fshat të vetëm. Natyrisht që historia e bëmave dhe personave të lavdishëm që kanë lidhje me Nivicë-Bubarin nuk mbyllet me sa përmenda më sipër. Nuk është qëllimi i këtij studimi të japë enciklopedisht gjithë historinë e fshatit të Nivicë-Bubarit. Ka me dhjetra libra, studime , artikuj e shumë dokumenta që pasqyrojnë e që trajtojnë gjërisht ngjarje deri në pronësinë e tokave të niviciotëve në mënyrë të veçantë mrekullinë bregdetase, Gjiun e Kakomesë si dhe Manastirin e tij, por dhe Ungjillin misterioz të këtij Manastiri.

Gjithmonë duke qëmtuar nëpër faqet e librit të Katherine Fleming gjejmë këtë paragraf që paraqet një fakt shumë domethënës për Nivicë –Bubarin:“ Tokat e tyre , të

Fshatrat e Bregdetit kanë lindur nga martesat e detit me malin

ndara në parcela, konsiderohen pjesë e çiflikut të pashait: për ata që i punojnë pashai ka ndërtuar fshatin e ri të Dyzet Shënjtëve, pasi shumë nga banorët e Nivicës janë dërguar të punojnë në tokat e tij

pranë Trekalasë në Thesali”.³

Ky paragraf, në fakt është marrë nga shkrimet e Leak-ut në vitin 1835 që K. Fleming e përdor si literaturë. Në një koment që Vladimir Kumi i bën këtij shkrimi të Leak-ut, konkludon se : “ Për të punuar tokat e niviciotëve të internuar dhe të kthyer në çiflik të tij , mbas pushtimit që i bëri atyre në maj të vitit 1798 , Ali Pashë Tepelena ndërtoi fshatin e dyzet shenjtëve, fshat që shtrihej në pjesën fushore – kodrinore të tokave të niviciotëve. Sipas historikut të fshatit Nivicë Bubar gjejmë një sërë emërtime të tokave mbi ujë si Rrëza e Mironinës, Gurajza, Angale, Turkthe, Shepere, Qafa e Rrethit, Ovllaqe, Çelete, Kapele, Krekëza, Gajdhure, Kuqezë e Peshkëpisë, Prroi i bardhë, Kakome, Lucë, toka këto që ndodhen vetëm reth e reth Nivicë –Bubarit. Poshtë fshatit , nga lindja dhe nga jug – lindja kodrat mbuloreshin me ullinj, ndërsa vreshtat mbulonin pjesën më të madhe të kodrave në fund të fshatit, luginën e Gajdhurit dhe Mironinën. Në tokat niviciote përveç grurit, kultivohej elbi, liri, thjerëza dhe batha. Pylli i Prodanit si pronë e përbashkët jepte lëndë drusore dhe për ndërtim dhe për zjarr. Këto janë fakte që vërtetojnë pasuritë e niviciotëve që merreshin dhe me blektori duke qenë fshat i kompletuar, i cili ishte i pasur jo vetëm me kisha, faltore e manastire por merrej dhe me përpunimin e drithrave, të lirit, rrushit, drurit etj. Punimi i enëve prej balte dhe i tjegullave, mullinjtë për bluarjen e drithit ishin pjesë e një baze për tregëti të mirë me Korfuzin dhe tokat salentine ne Italinë e jugut.

Në një shikim të kujdesshëm, duke studjuar gjeografinë reth e reth Nivicë – Bubarit shohim se ekzistojnë disa Qafa apo sheshe dhe gryka si:

1. Qafa e Gjashtës e cila për pozicionimin e saj ka oportunitetin toponomastik të jetë si rrjedhim i Qafës së

Fshatrat e Bregdetit kanë lindur nga martesat e detit me malin

Bastës. duke u bërë largimi nga emri “Basta” tek “Gjashta”. Me këtë mendim kundërshtohet dhe një ide e dhënë nga Mihal Ll. Jano se emri “Basta” rrjedh nga emri i kështjellës së Bashtovës,

³ po aty f. 120

e cila ndodhet në jug të Kavajës, më afër me Rogozhinën. Siç kemi trajtuar në këtë libër është pikërisht kjo zonë që ka qenë predominim i familjes së Bastajve, që më vonë ka qenë pronë shtetërore e Perandorisë osmane. Qafa e Gashtës është pika më kulmore e lidhjes disa anëshe me Sarandën, me Delvinën e me Nivicën e pastaj me rrugën e Bregdetit, ndryshe e thenë, me Himarën dhe pastaj me Vlorën e me fshatrat e Labërisë.

2. Qafa e Vlash Bubës, që përshkohet nga lugina apo koridori që lidh Nivicën me Delvinën. Vetë toponimi Buba është argument jo vetëm si emërdhënës i dallimit të Nivicës së Sarandës me atë të labërisë (Nivicë Lopësi) por edhe si mbiemër i njohur që në mesjetën e hershme në këto zona.

Kemi trajtuar gjërisht në pjesën e tretë të këtij libri figurën e Meksi Bubës, njeriut me emër të madh zyrtar i cili ishte pikërisht nga Nivicë Bubari.

3. Qafa e e Gjinos, merr emrin nga një personazh i historisë perderisa i ka dhënë emrin jo vetëm kësaj qafe, por dhe sheshit të Gjinos në Sarandë, kur dihet që Gjino është një mbiemër i përhapur në Nivicë Bubar. Sipas shumë dokumentave të historisë dhe të regjistrimeve në analet turke apo italiane del që Niviciotët kanë qenë zotërues të shumë



Manastiri i Kakomesë



Skema e Qafave pranë Nivicë Bubarit

tokave në një zonë shumë të gjërë rreth e rreth Nivicës. Mitro Gjini ka qenë një nga pinjollët e shumtë të fisit të Gjinajve.

4. Gryka e Matrëngës është e lidhur me mbiemrin e Lekë Matrëngës, mbiemër i cili ka shkuar që herët në fshatrat e Italisë së Jugut dhe ka një përhapje shumë të madhe. Dy nga priftërinjtë Bazilianë që ka ardhur në Misionet e Bazilianëve italianë në Bregdet kanë qenë Basilio Matranga dhe Filippo Matranga. Në Nivicë – Bubar ekziston një vendbanim i vjetër i quajtur Matrëng, pranë Dukshëve. Një histori më vete mund të hapet edhe për origjinën e këtij vendbanimi ...
5. Qafa e Mëkshi Mare, në afërsi të Nivicës është në vazhdimtë Kroit të Mare dhe përbën dhe ajo një element studimor duke plotësuar tabllonë e plotë të kësaj gjeografie interesante niviciote.
6. Lloka e Barbate njihet si toponomastike në Nivicë Bubar. Në dokumentat e Kishës së San Pietros dhe Paolos njoftohemi se Martino Barbato që ka punuar në periudhën 1598 – 1619 ka qenë prifti i ritit ortodoks dhe arkeprift në Spezzano Albanese, e cila në gjuhën arbëreshe thirret Spixana. Të mos harrojmë se po në këtë fshat me shqiptarë ka shërbyer dhe

prifti i fundit i ritit ortodoks, Nikolo Basta (1620 – 1666). Pra forcohet ideja e rrjedhshmërisë së emrit Barbate nga Nivicë Bubari në Spezzano Albanese, atje ku janë dhe Bastajt. Llaka e Barbate është një faqe e pjerrët që sheh nga ana e gjirit të Kakomesë, kur shkon rrugës për në këtë gji. Është në anë të fshatit Nivicë Bubar dhe në atë vend edhe sot janë mbeturina muresh e rrënoja të tjera të lashta. Tregohet se rreth viteve 1900 njerëz të panjohur kanë kërkuar në këto rrënoja dhe kanë gjetur flori, të cilin, natyrisht e kanë marrë. Janë këto ngarkesa toponomastike që hedhin dritë për vështrime të historisë ndryshe nga sa jemi mësuar të lexojmë jo vetëm në librat mbi historinë e Shqipërisë, por dhe në studime autorësh të veçantë shqiptarë apo të huaj.

Në dobi të sqarimit më të thjeshtë toponomastik po sjell këtu një përmbledhje të këtyre emërtimeve të sipërpërmendura: Rruga që zbret nga fshati Nivicë Bubar për në Delvinë, drejtohet te Kroj i Meks(h)e, vazhdon te Qafa e Meks(h)i Mares, Kurrizit të Peshkëpisë e tek Bazilika e Nivicës e me tej në Qafë të Lash Bubës (Meksi Buba ?!) (Në Nivicë dhe Shën Vasil gjendet me shumicë familje me mbiemrin Mekshi).

Me tej kur ikim nga Delvina për në Sarandë kalojmë te Qafa e Gjinos dhe më tej në Qafën e Gjashtës (Bastës?! Sebastja ?! Cifliku i Bastajve nga Nivica ?!) sipër fshatit Llaka e Barbate midis Kakomesë dhe Nivicës (vendbanimi i vjetër) në Shën Vasil , ku toponimi Fitea është për një pus të vjetër të zbuluar vitet e fundit. Këtë e vërteton dhe kjo këngë e vjetër e gjetur në dokumenta të kohës.

Kënga e Vjetër (1798)

Shokë ç'më ka zene malli !

Për seir te Barbakait

Dhe për ujë të Fitait

DY KONSTATIME MBI MËNYRAT E STUDIMIT TË HISTORISË

Eshtë një fenomen i çuditshëm që disa autorë të cilët studjojnë historinë e Bregdetit dhe jo vetëm të atij, aplikojnë një lloj manie për të evidentuar vetëm figurat më kryesore të kombit shqiptar gjatë gjithë historisë së tij. Kjo ka ndodhur në folklore, kjo ndodh në letërsinë e gjithanshme shqiptare, kjo ndodh dhe në studimet historike. Ndoshta kjo ka të bëjë me epizmin që populli shqiptar e ka shumë për zemër ndër shekuj. E kjo fillon mbase me Pjetër Bogdanin që nëpërmjet “ Sibilave ” prek tema kryesore të mitizmit dhe legjendave në krahinën e Hasit, nëpërmjet Biblës, vazhdon me Skëndërbeun i cili që nga koha kur Barleti botoi historinë e heroit tonë, edhe sot shkrimtarë e studjues merren me heronj të mëdhej e me ngjarje të mëdha pra vetëm më Skënderbeun. Por dhe për kohën e ilirëve ne shohim vetëm mbretëreshën Teutë, apo në periudhën e shekullit të XVIII, shohim me qindra libra e studime për Ali Pashë Tepelenën, mëtej vetëm për udhëheqës shteti si Ahmet Zogu apo Enver Hoxha e për të shkuar deri në periudhën heroike të popullit të Kosovës ku mbizotëron figura emblematike e Adem Jasharit.

Lind pyetja: – A ka patur heronj të tjerë krahas me këta heronj të cilët përmendën vazhdimisht?

Kësaj pyetje duhet t’i përgjigjen shumë e shumë shqiptarë sepse duke dalë nga “ mania e epizmit ” kudo që shfaqet, në letërsi, arte, histori etj, i shërbejnë thjeshtë kombit tonë.

Kështu që me studime më pak “ gjigante ” mund të njihen shqiptarët dhe të huajt se përveç heronjve “ top nivel ” ka dhe heronj të tjerë që kanë bashkëpunuar e kanë luftuar me heroin kryesor.

Fakte të shumta ka nëpër dokumente të ndryshme në arkivat e huaja edhe për persona që kanë bërë jehonë mbas vdekjes së Skënderbeut, apo pas shpërnguljes së shqiptarëve në brigjet përballë të Adriatikut e të Jonit, nëpër rajonet italiane.


Fenomeni tjetër është dhe përgjithësimi i çdo fshati të bregdetit, veçanarisht atij të Poshtëm me emrin e Himarës.

Pra edhe kur shumë studime për Bregdetin, flasin për historinë e tij, përqëndrohen thjeshtë me Himarën, duke detajuar rrallë fshatrat e Bregut të poshtëm. Ky përbën dhe fenomenin e dytë që ngjan me studjuesit në përgjithësi. Por këto fshatra studjohen me modesti nga autorë vendas, sipas fshatrave si për Shën Vasilin, Piqerrasin, Ftterrën etj.

Një nga këto vrojtime është dhe studimi që po paraqes në këtë libër mbi tre figura të fuqishme që kanë lidhje të ngushta me Nivicë - Bubarin, një fshat i cili veç kapëdanë ka nxjerrë ndër kohëra të hershme e të vona.



Hartë e përgjithshme e zonës rreth e rreth Nivicës ku tregohen pranë njëra tjetrës kishat, manastiret dhe faltoret e shumta.



Manastiri i Krorëzës

NJË NIVELIM KUFIJSH KOHORË

Është e rëndësishme që të nivelojmë kufijtë kohorë që krijojnë tabllonë tripike të Nivicë – Bubarit në periudhat që po studjojmë në mënyrë të veçantë. Le t'i shohim me rradhë: jetën apo kohëgjatësinë e veprimtarisë së tre figurave Gjergj Basta, Neofit Rodino, Meksi Buba.

- Gjergj Basta - lindi në 30 Janar 1544 dhe vdiq në 20 nëntor 1607
- Neofit Rodino - lindi në 1575 dhe vdiq në 1659. Jetoi në Bregdet 1628 deri në 1648
- Meksi Buba - mëkëmbës i përgjithshëm krahinës së Epirit, realizon me ndërprerje, mardhënie tregtare me Italinë 1615.

Përpara se të bëjmë lidhjet llogjike midis këtyre personave të lidhur organikisht me Nivicë Bubarin, është shumë e nevojshme të jap paraprakisht disa karakteristika të personave të renditur më sipër dhe pastaj të përdorim bisturinë e operacionit për të zbuluar ato që koha i ka mbuluar me dashje apo pa dashje.

E përpara se të filloj me karakteristikat e personave të renditur, dmth të Gjergj Bastës, Neofit Rodinos dhe Meksi Bubës le te paraqes një panoramë të shkollës dhe kishës së fshatit Nivicë –Bubar.Këtë panoramë e kam sjellë në këtë studim sipas Historikut të fshatit Nivicë – Bubar dhe librit “ Nivica –porta e bregdetit ” të Andon Baxhërrit:

“ Në krah të rrapit e shkëmbit ngrihet godina e vjetër e shkollës së fshatit, djegur më 1912 nga pushtuesit turq, e rindërtuar më 1917 nga ata italianë dhe më 1958 pësëri u rindërtua nga banorët e Nivicës dhe shërbeu me vite si shkollë 7 dhe 8 vjeçare e sot është pësëri godina e shkollës 9 vjeçare.

Kjo godinë e vjetër në pozicionin Lindje - Perëndim, duke patur përballë këmbanoren na bën të mendojmë se duhet të ketë qenë dikur kishë që stuhitë e shekujve e kanë shkatërruar. Po të vëresh një foto të vitit 1913 që e paraqet godinën të djegur, mendoj se ka qenë e tillë, kur shikon në faqe të murit dritare e porta të

harkuara me gurë të skalitur.

Në afërsi të shkollës, në të njejtin oboorr ngrihet kisha e Shën Dhimitrit, shek XVI, rindërtuar disa herë për shkak të shkatërrimeve të kohës. Në vitet 1970-1980 u shndrua në shtëpi kulturore. Në këtë kohë u dëmtua rëndë gjithë arkitektura e brendëshme e saj. Ikonostasi ,punuar me dru arre e argileje, në gdhëndje dhe zbukurime të mahnitëshme nga një dorë mjeshtri të paarritshëm, u dogj. U zhdukën ikonat shekullore, të formave dhe madhësive të ndryshme .

Muret e altarit të zbukuruara me afreske të kohës, u gërmuan, duke fshirë plotësisht atë thesar të mrekullueshëm të artit tonë shekullor. Kjo kishë mbahej si nga më bukurat në Bregdetin e Poshtëm. Pas viteve '90, ajo u transformua përsëri në kishë, por kurrë s'e arriti të parën. Përpara shkollës, në drejtim të Lindjes, ngrihej një kambanore, me mur guri e me arkitekturë të veçantë, shumë të bukur. Edhe kjo u prish nga themeli, duke ruajtur një vetëm si dëshmi të saj dy këmbana të mëdha që sot u rivendosën përsëri në kambanaren rindërtuar në vitin 1993, pikërisht në atë vend ku ishte ngritur afërsisht me arkitekturën e asaj kohe."⁴

Duke u munduar të rindërtoj historinë e ndërtimit të fshatit Nivicë – Bubar në vendin ku është sot, e duke parë këto lëvizje të shumta rreth e qark kishës, që ishte dhe është në qendër të fshatit, mendoj se kjo mbase është dhe periudha e ardhjes së niviciotëve në mal, duke u transferuar nga pjesët e poshtme. Vetëm emri Shën Dhimitër i kishës përbën dhe ai një argument me rëndësi për të besuar në mendimin e mësipërm. Paralel me këtë ide vjen dhe mendimi tjetër, ai i zgjedhjes së Shën Dhimitrit si shenjtor luftëtar që i shkonte për shtat jetës dhe karakterit të vetë niviciotëve.

Vetëm emri Shën Dhimitër është me rëndësi

Siç do të trajtohet dhe në vazhdim të këtij libri Dhimitri që është ndihmësi kryesor i bazilianit Neofit Rodino, dhe i lidhur indirekt dhe me Gjergj Bastën

⁴ Andon Baxherri . "Nivica –porta e Bregdetiti",Sarandë,Milosao,2010 f. 19

gjatë periudhës kur ky i fundit ishte në Spanjë e kur kërkohej me të madhe nga vetë përfaqësuesit niviciotë e lukoviotë, ndihma nga Kisha katolike e Romës për sjelljen e misionarëve. Po ky Dhimitër mund të ketë qenë ndër drejtuesit kryesorë në Manastirin e Kakomesë, apo në Manastirin e Shënvasilit.



Kisha e Shën Dhimitrit në Nivicë Bubar

Por janë dhe disa faktorë të tjerë të cilët duhen mbajtur parasysh për të argumentuar sa më mirë e që do të vijojnë gjatë studimit; do shtoj pikërisht dhe këto vende të tilla të religjionit rreth e rreth Nivicë-Bubarit.

Kisha e Shën Dhimitrit.

Kisha e Shën Kollit.

Kisha e Peçe në kodrën me të njëjtin emër.

Faltore e Shën Sotirës në Pjetrash.

Episkopata e Peshkëpisë (bazilikata).

Kishë bizantine(BAZILIKE) e shek. XVI—të

Kisha e Shën Argjërit.

Pagëzimore e Shën Kollit.

Manastiri i Shën Gjergjit.

Kisha e “Shën Marisë”- Manastiri i Kakomesë.

Manastiri i Krorëzës me kishën e Shën Marisë.

Faltore e Shën Premtes.

Kisha e Shëndëllisë.

Sipas të dhënave kronikale del që në vitin 1336 kisha është djegur kur Androniku i III Paleologu, ndërmori fushata të prishjes së kishave në Shqipëri. Krijimi i saj mendohet të jetë në shekullin e XII-të

Por nuk duhet harruar dhe Manastiri i Krorëzës që për mendimin tim ka patur lidhje të holla me vendet e shenjta për zonën hapësinore që mbulonte Nivicë- Bubari. I një rëndësie të veçantë ka qenë dhe Manastri i Shën Gjergjit në jug të tokave të niviciotëve. Për aq më tepër në Manastirin e Kakomesë ka patur bibliotekë që sipas informacioneve ka qenë shumë e pasur. Nuk po përmend këtu ungjillin madhështor të Manastirit dhe Kryqin misterioz të këtij Manastiri me emër të madh si Vend i Shenjtë në gjithë Shqipërinë e Jugut e deri thellë në tokat helenike.

Manastiret në zonën e Bregut të Poshtëm janë shembuj të dukshëm të artit arkitekturale bizantin. Janë të ndërtuara në vende të tërhequra nga vendbanimet dhe zakonisht në pozicione krejt të dukshme. Të tilla janë dhe dy manastiret që ndodhen pranë Nivicë-Bubarit.

Jano Koçi shkruan pikërisht për këto dy Manastire: “...Kisha e Shën Mërisë e ndërtuar mbi themele të vjetra bizantine është e tipit të zhvilluar në formë kryqi me kupolë e me tre absida....Mbishkrimet përmbi portën perëndimore të naosit dëshmojnë se kisha u pikturua nga i quajturi Mihal , në vitin 1672, në kohën e peshkopit Serafim, me kontributin e papa

Katër Manastire pranë tjetrit nuk është rastësi.

Mantheut.

Manastiri i Krorëzit, i ndërtuar në kreshtë shkëmbore dhe i mbuluar nga gjelbërimi. Kisha e Shën Mërisë që u pikturua në të njejtën kohë (1672) me atë të Kakomesë nga Mihali, përmban afreske murale me vlerë.⁵

Siç shihet nga këto “ fortifikime “ argumentat që do të trajtojmë palë palë do të kenë material dhe bindje “luftarake” jo vetëm për personin e Gjergj Bastës...Një faktor tjetër që ndihmon së tepërmi kuptimet dhe përfaqësimet e ndryshme lidhen me pozicionin administrativ të Nivicë-Bubarit.Në se më lart theksova pozicionin e sotëm administrativ të fshatit Nivicë- Bubar, si pjesë e rëndësishme e Komunës së Lukovës, por ndryshe kanë qenë pozicionimet e këtij fshati në rrjedha të shekujve.Në shumë libra të shkruara për krahinën e Himarës riprodhohen dokumenta ku fshati Nivicë bën pjesë në Rajonin dhe Peshkopatën e Himarës, në vitin 1581, muaji shkurt.⁶

Po jap të plotë listën e fshatrave që përmenden në Rajonin dhe Peshkopatën e Himarës në letrën dërguar Papës së Romës, Gregorit XIII. Kjo listë është në fund të letrës dhe shoqërohet me këtë shënim:“Unë, Michele Argjiro, nga ishulli i Korfuzit, kam shkruar dhe nënshkruar me dorën time, sipas vullnetit të zotërinjve të Rajonit të Himarës dhe të fshatrave të sipërpëmendura. ”Ja dhe lista e fshatrave pjesëmarrëse në hartimin e letrës:

DUCHATES, BROCCOTO, CALOJERATYES,TRUMBAZEI, SOTIRIANE, BALASSA, PANGALADES, DRIMADES, HELIATES, BUNAE, CHAPERAS, CUDISSEI, PILURE, CUZEI, PROGONATES, LUPESI, CASTELLI, NIVIZA, PICERNATES, BUNEZZE, TURNECHEI, BUBAREI, ORESTA, BAFADES,TERNA, ZAROCORIZA, CAMINIZZA, FENECAE, DAMISEI, LEHELTI, DRAGOTES, CARIANA, CHUNEHIZA, PESTANAE, BERNACHUS, CEPRIOTA, AIOBASILES, ZULATES.

Natyrisht që këto të dhëna janë të dhëna të marra nga libri i Nilo Borgias, të cituar në këtë studim. E njëjta listë jepet dhe në studimin e prof.dr.Petrika Thëngjilli “Aspekte të përpjekjeve të Himariotëve për liri (shek.XVI-XVIII) - në librin “Himara në shekuj”

⁵ Jano Koçi “Himara”, Gent Grafik, Tiranë 2006

⁶ Llambro Ruci “ Himara dhe zëra Akrokeraune”, Tiranë 2011. f,159

–Akademia e shkencave të Shqipërisë-Tiranë , 2004,f,124.

Me pak ndryshime edhe prof.dr. Ferit Duka jep tablo të njëjtë marrë nga defter i hollsisëm i Sanxhakut të Delvinës në vitin 1551 dhe 1583 ku fshatrat e Bregut përfshihen në Krahinën e Himarës -“Himara në shekuj”- artikulli “Aspekte social-ekonomike dhe demografike të Himarës gjatë sundimit osman” (shek.XV-XVI) f.68,75-77.

Por, duke ndjekur rrjedhat e ngjarjeve dhe dokumentet e kohës, lind mendimi se vetë Nivica me gjithë këto objekte kulti në qendër të fshahtit dhe rreth qark saj, ka qenë episkopatë më vete, me influence shumë të gjerë gjeografikisht.Këtu na vjen në ndihmë dhe konstatimi që Vladimir Kumi bën në artikullin e tij për Kakomenë e ku thuhet:

*Vetë Nivica ka qenë
episkopatë më vete*


“ Të parët e mi (niviciotët, shënimi im, F.M.), të vendosur me banesa që nga Volloderi deri në fshatin e sotëm, kontrollonin gjithë bregun perëndimor të derdhjes së lumit të Kalasës dhe të Bisticës (që atë kohë kalonte rrzëzë Finiqit të lashtë duke zbritur në liqenin e Butrintit). Pronat e tyre zbrisnin deri në Ksamil rrzëzë Butrintit dhe Vivarit që kufizoheshin me Konispolin dhe Çamërinë.”⁷

Siç shihet nga lista e mësipërme fshati Nivicë Bubar jepet në dy pjesë përkatësisht NIVIZA dhe BUBAREI. Në vazhdim të konstatimeve të mëtejshme do të hedhim dhe mendimin mbi bashkimin e të fshatrave në një emër të vetëm : NIVICE - BUBAR.

⁷ Vladimir Kumi. “Ç’është dhe ç’përfaqëson Kakomeja”, www.himara.eu/adver/KHimariot/004.pdf

Intermexo nr 1

I ndjeri Theofan Popa ka lënë një trashëgimni të vyer edhe për historinë e fshatrave të Bregdetit në librat e tij. Një vrojtim i tij është dhe ai i këmbanës së Manastirit të Krorëzës ku ka përkthyer mbishkrimin e gdhendur në këtë këmbanë. Ja se si shkruhet në këtë mbishkrim krejt të jashtëzakonshëm për historinë tonë.



Këmbana e Manastirit të Krorëzës

“Për kujtim të ushtarëve shqiptarë të mbretit të dy Siçilive që ranë, nga katundi Lukovë, Muzinë 1813, prej meje, Raponci”

Ky mbishkrim përkushtimi gjëndet i punuar mbi relief rreth këmbanës së Manastirit të Shën Mërisë, Krorëz, ngjitur me Nivicë –Bubarin.

Është shkruar me germa të përzjera greke e latine. Dy fjalët e fundit (prej meje Roncit) i japim me reserve. Nuk dihet në se fjala Misinë e mbishkrimit i referohet një katundi të vogël, po me atë emër, që sipas një gojëdhëne lokale të Shën Vasisë, ka pas ekzistuar dikur në bregdetin tonë, pranë Lukovës, apo qytetit Italian, Mesina.

Mbishkrimi dokumenton faktin historik të njohur, sipas

të cilit repartet ushtarake himariote kanë shërbyer në ushtrinë e Ferdinandit të Napolit , mbretit të dy Siçilive.*

Sot kjo këmbanë nuk ndodhet më në Manastirin e Krorëzës. Por mbeten këto dokumenta që tregojnë jetën, bëmat dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me historinë e popullit të Bregdetit.

A nuk është kjo një dëshmi reale për jetën dhe veprat e bregdetasve!? Po kështu në Historikun e fshatit Nivicë – Bubar gjejmë disa të dhëna për angazhimin e niviciotëve në veprimet luftarake në kontinentin italian e më gjerë .Ja një pasazh nga ky historik:

“Në ushtrinë e mbretit të Napolit kanë qenë dhe fshatarë niviciotë të quajtur **“cadeti”**, rekrutë në formacionet ushtarake **“ Real Macedone”**. Këtë e shikojmë dhe në një dokument ku prindërit e këtyre luftëtarëve janë propozuar për t’i shpërblyer si Stefan Dhuli, Logo Dashi, Vrana Prifti, Spiro Bodini, Gjik Spiro Laska, Ilija Spiro etj.⁸

*Theofan Papa. “Mbishkrime të kishave në Shqipëri” f.151-157 Tiranë

⁸ Historiku i fshatit Nivicë Bubar, 1979 , f. 59-60, Ruhet në Muzeun e fshatit Nivicë – Bubar.

Repetita invant.

Eshtë e dobishme të përsërisësh gjërat.

Seneka

PJESA E DYTË

Gjergj Basta

GJERGJ BASTA - GJENERAL I SHQUAR STRATIOT NGA NIVICE - BUBARI

“Ishte një gjenaral imperial (Perandoria e Shenjtë e Romës) dhe teoricien ushtarak. Ka shërbyer në lufrat franko -spanjolle në vitet 1589-1593 dhe në luftimet e gjata turke –habsburge, 1593-1606”⁹

Studjuesi italian L. Crasso në studimin e tij për kapitenë të shquar të kohës, jep me detaje portetin e Gjergj Bastës: “Stradioti me origjinë shqiptare, Gjergj Basta kishte fytyrë të plotë me tipare të rrepta, hundë shqiponjë, sy të mëdhej, ishte shtatë lartë dhe esmer, me gjymtyrë të shëndoshë dhe trup atleti, ishte sypatrembur në beteja dhe mjeshtër i vërtetë në përdorimin e armëve, i etur për fitore dhe lavdi. Shquhej si besimtar në fe dhe ishte njeri i fjalës, armik i përbetuar i trathtisë dhe i pabesisë. Ishte i pakorruptueshëm dhe zemërohej lehtë; ishte shumë dyshues dhe kishte një shpirt shumë hakmarrës si dhe kishte shumë zili për lavdinë e të tjerëve; nuk përtonte kurrë të ishte i pari në betejë dhe të tëhiqej i fundit nga ato.”¹⁰

Gjergj Basta duhet të ketë qënë ndër gjeneralët më të shquar të kohës sepse në listat që rendisin analistët e kohës ai vendoset i pari e më pas vinë strategë të tjerë europianë si Gall Peter, Leopold William, Lennart Torstensson, Richard Wallis. Kjo renditje është marrë nga vepra të botuara.

⁹ “Thirty years’ war Enciclopedy”- Early modern warfare society’s

¹⁰ L. Crasso-“Elogi di capitani illustri” botim i Vatikanit, 168

ORIGJINA

Gjergj Basta lindi në 30 Janar 1544 në Roccaforzata (ish Rocca) në Provincën e Tarantos, në Itali. Ai vinte nga një familje fisnike ose aristokrate shqiptare siç e japin disa burime. i ati, Dhimitri kish lindur në Shqipërinë e Jugut, në qytezën e Bastës, të cilën e kishin në zotërim si familje. Kjo qytezë ndodhej midis Butrintit dhe Sarandës. Si qytezë ishte ndërtuar nga venedikasit . Gjyshi i Gjergj Bastës i quajur Andrea kishte qënë luftëtar me Skënderbeun e më pas si mercenar kish hyrë në forcat e Mbretit të Napolit.

Per sa i përket origjinës së familjes së Gjergj Bastës ndonëse ka adresime të ndryshme që të gjitha rrahin në një drejtim: një vend pranë Sarandës si psh “Djali i Dhimitrit stradiot, i ardhur prej Mores (me origjinë prej viseve të Arbërisë)¹¹, ose “Gjyshi i tij Andrea Basta, bashkëluftëtar i Skënderbeut, ishte nga fshati Bastje, afër Butrintit të Sarandës ”¹². Në dokumentat e shumta si dhe në shumë biografi të shkruara në gjuhë të huaja thuhet se i jati i Gjergjit, Dhimitri, duke mos duruar pushtimin osman, ai së bashku me familjen dhe me shumë bashkëqytetarë fisnikë po si ai u shpërngulën në provincën e Tarantos.¹³

Në një dokument tjetër lidhur me origjinën e Gjergj Bastës thuhet se: “ Duke qënë nga një familje fisnike shqiptare, i ati, Dhimitri, kishte lindur në Shqipërinë e Jugut, në qytetin e Bastës, të cilën e kishte marrë në zotërim dhe e cila ndodhej midis Butrintit dhe Sarandës. Si qytezë ishte e ndërtuar nga venedikasit. “

Siç kemi analizuar në këtë libër vendodhjen e fshatit apo qytetit Basta, rezulton se kemi të bëjmë as më shumë e as më pak me toponimin “Gjashta” që nuk është gjë tjetër veçse zona

¹¹ Anton Kaçubaj.Gjergj Basta,gjeniu arbëresh i artit luftarak, fletorjashqiptare. com/gjergj-basta-gjeniu arbnesh-...

¹² Forumi shqiptar-www.forumishqiptar.org/showthread.php=82453

¹³ Po aty

e Lëkurësit dhe zona e dyzet shënjtoreve apo dyzet martirëve të Sebasties.

Toponimi i tanishëm “Qafa e Gjashtës” bën fjalë pikërisht për këtë qytet me emrin Basta, kaq pranë Nivicë – Bubarit. Niviciotët kanë qenë zotërues jo vetëm të zonës së Bastës, por, duke u nisur nga teoria e toponimeve, rezulton se emërtimet e luginave të ndryshme kanë të bëjnë me mbiemra të banorëve të Nivicë - Bubarit. Kështu përveç Qafës së Gjashtës, është dhe Qafa e Vlash Bubës, Qafa e Mekshi – Mare, Sheshi i Gjinos në Sarandë, gryka e Matrëngës etj.

Është e pranueshme se me kalimin e shekujve kanë ndodhur mbimbullime të zonave por emrat kanë mbetur ata që kanë qenë e nuk janë transformuar.

Me vlera të konsiderueshme janë dorëshkrimet dhe letërkëmbimet e Gjergj Bastës, një pjesë e mirë e të cilave ruhen të shpërndara në Arkivin Sekret të Vatikanit; në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit; në Arkivin e qytetit të Venetikut; në Bibliotekën Nacionale Qëndrore Marciana të Venedikut; Bibliotekën Civico të Muzeut Korrer të Venedikut; në Arkivin Shtetëror Hungarez; Bibliotekën Kombëtare Szecheny të Budapestit; Bibliotekën Kombëtare të vjenës, Bibliotekën Nacionale të Katalunjës etj.

Duke rrëmuar në dokumenta dhe studime të autorëve tanë shqiptarë si në studimin analitik të prof. Pëllumb Xhufi gjejmë këtë informacion të rëndësishëm :

“ Në 1608 u bë një orvatje tjetër për sigurimin e ndihmave. Kësaj rradhe himariotët iu drejtuan drejt për së drejti spanjollëve. Si negociatorë të tyre u dërguan në Napoli.

Dhimitër Basta nga Nivica (Nivicë- Bubari) dhe prifti Gjon Klosi nga Lukova, të cilët sollën një letër të peshkopit të Himarës dhe të Delvinës, Jeremisë dhe i deklaruan kontit Benavente se ata dëshironin të viheshin në sundimin e Spanjës”.¹⁴

Këto të dhëna shihen dhe në një shkrim të Petër Bartl, studjues i sllavistikës, turkologjisë dhe historisë së Europës Lindore..

¹⁴ Pëllumb Xhufi “ Stratiotët himariotë ” Konferenca e III-të pan-Himariote-“ E kaluara 2600 vjeçare –një thesar për të ardhmen”

Pikërisht mbi librin e këtij studjuesi gjerman, prof. Pëllumb Xhufi ka ndriçuar histori ende të pastudjuara të popujve në hapësirë Ballkanit Perëndimor, duke sjellë materiale të panjohura dhe të pavlerësuara më parë. Edhe në Enciklopedinë Rumune origjina e Gjergj Bastës jepet saktësisht si shqiptar, e për më tepër jep dhe aktivitetin e tij të gjërë ushtarak.¹⁵

Në studimet e viteve të fundit rezultojnë disa konkluzione të çmueshme gjejmë shumë të dhëna për familjet fisnike shqiptare të bregdetit jugor shqiptar në Salento.

Kështu autori i apasionuar Halil Myrto në artikullin e tij mbi “Një kontribut në analizat e dëshmimeve të gjuhës shqipe në Salento” i cili është botuar italisht në revistën periodike Dyrrah, N. 5, botim i vitit 2010 shkruan se: “Shqiptarët në Salento, siç nënvizohet nga G.Gabrieli, “për më shumë kanë qenë ushtarë dhe bujq, por dhe fisnikë dhe luftëtarë”.¹⁶

Dhe më tej vazhdon :“Midis familjeve fisnike , me origjinë shqiptare , të stabilizuara në Salento gjatë mesjetës dhe që kanë luajtur një rol të madh në zhvillimin historik dhe kultural të rajonit(regione) ,veç Kastriot –Skënderbejtë dhe Aranitëve të përmendur, gjejmë: **Bastat**, Kapuzimati, Jonima, Muzaka, Zakaria, Teko etj.¹⁷

*Karl Basta ish i biri i
Gjergj Bastës*

Në rrjedhën e hulumtimeve për të saktësuar sa më mirë figurën e Gjergj Bastës kemi gjetur dhe një dokument me shumë vlera, që si shumë dokumenta të tjera vjen nga literaturë kishtare. Është fjala për librin e Vinçenx Llongut me titull “Arkipriftrat e Spixanës”, një botim i kishës së Shën Pjetrit dhe Paolos.

Në këtë libër flitet shkoqur për priftin e quajtur Karl Basta i cili ka lindur në vitin 1625 dhe ka vdekur në vitin 1647, në Spezzano Albanese.

¹⁵ enciclopediaromane.ro/wiki/Giorgio_Basta,ku thuhet: Giorgio Basta (cunoscut in istoriografia romanesca si cu numele romanizat Gheorghe), a fost un general Italian, de origine albanes

¹⁶ Halil Myrto ,Revista Dyrrah, n5 ,f, 30

¹⁷ Halil Myrto, po aty ,f 30.

Gjithmonë sipas autorit të sipërpërmendur, del që prifti Karl Basta ish i biri i gjeneralizmit Gjergj Basta. Periudha kur ka jetuar ky prift përputhet pikërisht me kohën kur u hap shkolla e Nivicë Bubarit , siç e kemi analizuar gjatë në pjesën e dytë të këtij libri, kur flasim për Neofit Rodinon. Po riprodhoj tekstin origjinal nga libri i Vinçenx Llongut kur flet për priftin Karl Basta:

“Papasi Karll Basta (1625 - 1647)

Janë pakund e shumë të mbrulartura lajmet që rrëfihen për atë. Ish i biri, kushedi, i Komisarit Xhenerall e Kontit i Perandorisë Rromane së Shenjtë, Gjergj Basta, Zoti Karll u le, pa ëhojo, Spixanë rreth vitit 1586. Zu karrjerën e tij si prift ndë vitin 1614, ndërsa ndë vitin 1617 tek aktet e pakëzimit gjëmi shkruajtur se thrritet kapellan. Kish martuar Zonjën Martina Maneze ka Ungra me të cilën pat tre bilë: Gjergji, Nikolo, e Kozmi. Të Gjergjit kemi pak lajme, Nikolo që i lurtmi arçiprift i ritit bixandin Spixanë, ndërsa Kozmi, i llaureartur si “jatrua fizik”, bëri jatroun.”

Këto dokumenta janë marrë nga Arkivi i Kishës së Shën Petrit dhe Paolos në Spezzano Albanese.

Gjergj Basta nga fundi i aktivitetit të tij të shkëlqyer ushtarak pat blerë në vitin 1594 feudin e San Martinos dhe në vitin 1606, para se të largohej nga jeta aktive ushtarake, kish blerë edhe feudin tjetër të Monteparanos. Një argument tepër i rëndësishëm është dhe fakti se tokat që ka blerë Gjergj Basta në Italinë e Jugut siç është se feudi i Monteparanos është në kufi më Roccaforzata, fshati ku ka lindur Gjergj Basta. Kemi të bëjmë me provincën e Tarantos dhe rexhionen e Puglias. Këto janë argumente të mira për të ndihmuar idenë se ardhja e Rodinos në Nivicë Bubar është e iniciuar dhe financuar nga vetë Gjergj Basta dhe rethi i tij fisnor. Për këtë flasin dhe përputhjet kohore që i kemi trajtuar në pjesë të ndryshme të këtij libri.

Ekziston dhe një e dhënë tjetër lidhur me të vëllanë e Gjergj Bastës që quhej Nikolla dhe që sipas literaturës thuhet se” nga kjo derë ka dhe mjaft emra të njohur siç është ndërmjet tyre

Nikolla Basta, një jurist, autor i një vepre mjaft të rëndësishme të së drejtës botërore”. Këtë konstatim e gjejmë në shkrimin studimor të Mihal Ll. Janos.*

Por dhe një Nikollë Basta ka qenë prift në fshatin Spixana (Spezzano Albanese) që ka shërbyer në periudhën 1662 – 1666. Për familjen Basta ka edhe të dhëna të tjera që ajo vjen nga Epiri dhe është vendosur në Salento. Studjuesi Rohlfs, sipas artikullit të lartëpërmendur të Halil Myrtos , në fjalorin historik të mbiemrave salentinë, ka konsideruar shqiptarë këta : Basta (Messagne), familje shqiptare e ardhur nga Epiri, Bishi (Sava) etj.¹⁸

Në artikuj të ndryshëm gjenden edhe origjinat e mbiemrit Basta për të cilën thuhet në një listë të mikrotoponimeve me origjinë shqiptare, se Basta vjen si emër i një shtëpie të madhe, në kuptimin fisnik.¹⁹

Në artikullin e paraqitur nga H. Myrto, jepen tre shtojca shumë interesante që janë lista meshumë vlera, titujt e të cilave po i paraqes këtu:

1. Lista e emrave dhe mbiemrave me origjinë shqiptare.
2. Lista e mikrotoponimeve me origjinë shqiptare .
3. Përputhje leksikore midis dialekteve të Salentos dhe shqipes.



Medalje me portretin e Gjergj Bastës

* Mihal Ll. Jano. - Familje arbërore të njohura në vende të ndryshme të Mesdheut. – dorëshkrim botuar në portalin “Kritika “ 16. 10. 2012

¹⁸ Halil Myrto ,Po aty ,f,28

¹⁹ Halil Myrto,Po aty ,f,43.

AKTIVITETI LUFTARAK

Lavdinë e parë Gjergj Basta e ka gjetur në Armatën Spanjolle ku pas një kohe arriti të emërohej komandanti i kalorësisë së lehtë në luftën e Flandrës, luftë që udhëhiqej nga Aleksandër Farnese që ishte dhe Princ i Parmës. Por para se të arrinte gjer në këtë emërim të parë zyrtar, Gjergj Bastës iu desh që të largohej nga vendi i lindjes Roccaforzata e të ndiqte studimet në Asti të Piemontes, në veri të Italisë. Pasi i mbaroi studimet në Asti ku u shqua për një zgjuarsiri të rrallë dhe aftësi të veçanta në artin ushtarak, atë e çojnë në Akademinë Ushtarake të Hollandës, të cilën e përfundoi me rezultate të shkëlqyera. Nga shumë burime dokumentare të



kohës rezultojnë se Aleksandër Farnese, Princ i Parmës, ishte mik i familjes Basta dhe ka ndihmuar në shumë raste ecjen përpara të të riut Gjergj Basta. Fillimet e aktivitetit luftarak në Spanjë, u realizuan në saj të ndihmës së madhe të Aleksandër Farneses. Njohja e personalitetit ushtarak të Gjergj Bastës, në Spanjë arrinte gjer në personin e mbretit të Spanjës. Kur Aleksandër Farnese merr pushtetin në Vendet e Ulta, ai e emëron Gjergjin si komisar të përgjithshëm të repartëve kalorësiake për tërë Vendet e Ulta, në vitin

*Gjergj Basta ishte
me origjinë nga
Nivicia*

1580. Sipas disa burimeve thuhet se Gjergj Basta kish kryer më parë dhe Akademinë e Aleksandër Farneses. (Sipas dokumentave të paraqitura në pikën 9, më sipër)

Një dokument që është në fakt letra që pleqësia e Himarës i dërgon në vitin 1759 carinës ruse Elizaveta Petrovna, jep në mënyrë të përgjithëshme këtë veprimtari të Gjergj Bastës në Spanjë:

“...Gjatë periudhës së luftës hollandeze (1566-1609), mbreti i Spanjës, Filipi i II- të , kishte shumë himariotë në këmbësorinë dhe kalorësinë e tij nën komandën e gjenaralit himariot Gjergj (Georgi) Basta.”²⁰

Duke përmendur Gjergj Bastën në letrën e tyre, pleqësia e Himarës mburret me këtë bir të Bregetit, pavarësisht se shkruesi i letrës, nuk e ka theksuar saktë origjinën e Gjergj Bastës. Ky është një problem që zgjidhet në këtë libër. Ajo që duket më interesante është fakti që Gjergj Basta reth vitit 1579 shihet si komandant i një trupe (regjimenti) kalorësie prej 200 luftëtarësh të stërvitur mirë dhe të gjithë shqiptarë, të ikur nga trojet shqiptare në Itali.(10). Kjo përforcon një sërë dokumentash që janë të botuara.

Prandaj shpesh në literaturën ushtarake që flet për stradiotët në shekullin e XV dhe XVI stradiotët shqiptarë i grupon me dyfjalëshin “stadiotët shqiptaro –arbëresh”.

Gjatë kohës si komisar i përgjithshëm me trupat e tij që i komandonte përballoi me sukses sulmet që i bënte Henriku i Novarës. Në vartësinë gjithmonë të mikut të tij Aleksandër Farnese ai realizoi me fitore këto beteja:

--1584—lufton në rajonin e Anversit(Holandë).

--1588—vlerësohet si një nga komandantët më të merituar në betejën ku mposhti Bonin.

--1590—shkon në Francë në ndihmë të Lidhjes së Krishterë dhe korri fitore të shkëlqyer.

--1593—merr pjesë në fushatën e Manofeldit (Francë)

²⁰ sipas letrës së Jorgos Lekakis botuar në 2010

Mbasi miku i vet Farnese vdes, Gjergj Basta e ndjen se i bie respekti për të dhe kalon në shërbim të Perandorisë Austro-Hungareze, në 1596.

Së bashku me ushtarët e tij, ku predominonin shqiptarët sistemohet në luginën e Danubit. Ai korri fitore të shumta kundër Osmanëve, tartarëve, vllahëve, transilvanëve dhe protestantëve hungarezë. Kështu bëhet Kryekomandant i Përgjithshëm i Perandorisë Austro - Hungareze për Hungarinë dhe Transilvaninë, duke u emëruar njëkohësisht dhe Guvernatori i të dyjave këtyre krahinave. Eshtë kjo periudha që fiton gradën më të lartë – gjeneral-(generalisimus).

Në fillim të vitit 1600 fillon nje etapë e re në karrjerën ushtarake të Gjergj Bastës. Perandori gjerman Rudolfi II, e fton atë si komandant kryesor përkrah me Michaelin e Vllahisë, për Hungarinë. Sipas kronikave të shumta del që për shkak të ambicjeve të ndryshme që kishte në pushtimin e tokave në kundërshtim me Perandorin Rudolf II, ai, Michaeli i Vllahisë nga përkrahës ushtarak me Gjergj Bastën kthehet në armik të tij. Pas shumë betejash me Michaelin e Vllahisë, Gjergj Basta del fitimtar. Pas vrasjes së Michaelit të Vllahisë, Gjergj Basta arriti të bashkojë Moldavinë, Transilvaninë dhe Vllahinë nën Perandorinë Austro – Hungareze.

Nën vartësinë e Perandorit gjerman Rudolf i II Gjergj Basta udhëhoqi mbi 100 beteja duke luftuar në shtetet kryesore europiane të asaj kohe kundër Perandorisë Osmane. Per të gjitha këto arritje të mëdha ushtarake, Rudolfi i II e emëroi në vitin 1605, Gjergj Bastën Kont të Perandorisë së Shenjtë Romane. Eshtë me vlera të theksoj se të gjitha këto të dhëna përputhen në të gjitha enciklopeditë europiane e sidomos ato rumune, hungareze, franceze, italiane, spanjolle etj.

Gjergj Basta njihet në shumë dokumenta edhe generalizmus edhe Kont i Perandorisë së Shenjtë Romane, për veprimtarinë e shquar ushtarake.

Gjergj Basta ishte gjene realizmus dhe Kont i Perandorisë së Shenjtë Romane



Beteje e Gjergj Bastës



Pamje nga beteja e Goro szlo'

AKTIVITETI TEORIK MBI STRATEGJINË USHTARAKE

Në vitin 1605 tërhiqet zyrtarisht nga fushatat luftarake dhe i përkushtohet përpilimit të strategjive dhe të taktikave ushtarake. Veprat më kryesore janë:

Mjeshtri i kampit general	1606
Mbi qeverinë e kalorësisë	1600
Qeveria e kalorësisë së lehtë	1612

Libri më i rëndësishëm për të gjithë opinionin e teoricienëve të artit ushtarak, është libri i tretë i Gjergj Bastës. Ky libër cilësohet si një vepër unike me influencim të madh për organizimin, drejtimin dhe plotësimin e kalorësisë së lehtë. Libri i tretë është përkthyer në shumë gjuhë europiane dhe është përdorur duke ndihmuar të njohë, të informojë ushtrinë europiane me doktrinën dhe praktikën dhe ky libër u përdor për Luftën 30-vjeçare. Sipas këtij libri, leksioneve të tij kanë ecur në artin e tyre ushtarak ushtarakët e mëdhej të kohës si Montecuccoli dhe Saxe.^{21 22}

Ja si shkruan studjuesi dhe përkthyesi Fotaq Andrea për librat e teoricienit ushtarak ,Gjergj Basta:

“Dukuria stradiote shqiptare, si një shprehje e artit ushtarak të lashtë shqiptar, do të përsosej në periudhën e Skënderbeut dhe do të shndrohej shumë shpejt në kontribut me vlerë për vetë artin ushtarak europian.

Për herë të parë do të futej në këtë të fundit taktika dhe strategjia e kalorësisë së lehtë shqiptare, e cila do të sintetizohej më pas në veprat e Komisarit të Përgjithshëm të kalorësisë europiane, shqiptarit Gjergj Basta , me veprat e tij “Mbi qeverisjen e kalorësisë së lehtë “ 1912 dhe “Mbi detyrat e shtatmadhorisë”1606”.²³

²¹ Barbarich,E.”Un generale di cavaleria italo-albanese : Giorgio Basta”-Nuova antologia-,63, 1928

²² Labarre de Raillicourt, Dominique. ”Basta : Comte d’Hust et du Saint-Empire” Paris ,1968

²³Andrea, Fotaq.”Shqipëria në NATO, një kontribut me zanafillë të lashtë”

www.zemrashqiptare.net/Fotaq__Andrea:Shqip...



Kopertina e librit të Gjergj Bastës
“ Mbi qeverisjen e kalorësisë së
lehtë”



Kopertina e librit të Gjergj Bastës
“Mjeshtri i kampit gjeneral”

Intermexo nr 2

Stratitë apo stradiotë

Gjeneralizmi shqiptar Gjergj Basta është një nga figurat më të shquara të stratitëve. Në një renditje botërore të figurave më të shquara stratitote Gjergj Basta vjen i treti si më poshtë:

Mercurio Bua
Krokodeilos Kladas
Giorgio Basta
Matthew Spanoudes
Graitzas Paleologos
Manolis Paleologos
Teodoros Paleologos
Demetris Laskaris etj

Ç'janë stratitët?

Stratitët janë njësi luftarake prej Ballkanit të rekrutuar në më të shumtën e herëve nga shtete të Europës Qëndrore dhe asaj Jugore nga shekulli XV deri në shekullin XVIII.

Emri i tyre vjen nga greqishtja që nga kohët e lashta dhe ka kuptimin e “ushtarit”, gjë që vertëtohet në veprat e Herodotit. Kjo fjalë është përdorur vazhdimisht në periudhën Romane dhe atë Bizantine. Por ky emër mund të ketë dhe një shpjegim tjetër që rrjedh nga gjuha italiane, pikërisht nga fjala “strada”- rrugë e që stratitët janë kështu stradiotë, dmth ata njerëz që rrugëtojnë...

Stratitët në shumicën e tyre janë kryesisht shqiptarë, grekë, dalmatinë, serbë dhe qipriotë.

Shumica e historianëve modernë konsiderojnë stratitët vetëm shqiptarët.**

**Pappas,Nicholas C.J.-“Stratitot Balkan Mercenaries in Fifteenth and Sixteenth Century Italy”-Sam Houston State UNIVERSITY.-

Burime të ndryshme mesjetare me stratiotë nënkuptojnë ushtarë me origjinë greke apo shqiptare. Kjo ndodhte sepse shumica e ushtarëve me origjinë shqiptare vinin nga rajonet shqiptare të helenizuara të Greqisë, ndërsa për ushtarët –stratiotë shqiptarë që vinin nga Italia dhe që mund të quheshin italianë nuk ishin veçse ushtarë arbëreshë apo ushtarë të Bregdetit shqiptar por të shkëputur nga feja ortodokse e që kishin kaluar në Kishën Unite.

Shënim kompletues.

Për Gjergj Bastën edhe në Fjalorin Enciklopedik shqiptar jepet një përshkrim i shkurtër, i përgatitur nga Riza Drishti. Më përjashtim të disa mospërputhje datash apo ndonjë ngjarjeje, të dhënat janë të mjaftueshme për një enciklopedi (FESH). Kështu, për të qenë më konkretë po e jap të plotë tekstin e shkruar në këtë Enciklopedi:

BASTA Gjergj Dhimitër(1550-1607).

Strateg, teoricien, ushtarak dhe gjeneral me famë europiane dhe botërore, me origjinë nga arbëreshët e Italisë. Lindi në fshatin Rokaforcata (Roccaforzata), pranë Tarantos (Itali), në një familje me tradita ushtarake. Gjoni dhe Andrea Basta ishin bashkëluftëtarë të Skënderbeut në fushatën e Italisë në v.1460-1462 (shih: veprimet luftarake të Gjergj Kastriotit në Itali në v.1460-1462). Rridhnin nga fshati Bastja, midis Sarandës dhe Butrintit. (Ky përcaktim që bëhet nga literaturë e përgjithshme është objekt i studimit në këtë libër (F.M.).

Studimet i kreu në qytetin Asti (Itall). Zotëronte gjashtë gjuhë, Babai, Dhimitri e mori Gjergjin që 15 vjeç në ushtri, në luftimet e Piemontit. Shërbeu në ushtri dyzet vjet. Arriti nga ushtar i thjeshtë, kalorës arbëresh deri në gradën më të lartë ushtarake: gjeneralizim. Organizoi, drejtoi dhe zhvilloi shumë luftime dhe beteja si kryekomandant i ushtrive spanjolle në Belgjikë, Holandë

dhe Francë dhe i ushtrive gjermane në Hungari, në malet e Ballkanit, në Transilvani kundër ushtrive osmane. Gjeneral dhe kont i trashëgueshëm i perandorisë së Shenjtë Romake, në Gjermani. Kont i trashëgueshëm i qytetit të Hustit në Hollandë, Governorator i Vjenës, (Austri).Përçues i traditës së përdorimit dhe drejtimit të kalorësisë së lehtë të ushtrisë së Skënderbeut në Itali, në ushtritë europiane të shek.XVI-XVII. Gj.B. shkroi tri vepra teorike dhe praktike ushtarake, të cilat u njohën në Europë: " Il maestro di campo generale" (" Mjeshtri i kampit të përgjithshëm", 1606 " Governo della cavalleria leggera" ("Për drejtimin e kalorësisë së lehtë",1612). Ato u përkthyen nga italishtja ,u botuan dhe u ribotuan frëngjisht, gjermanisht, spanjisht që nga shek.XVII deri në ditët tona; dy të parat u botuan shqip në vitin 1966. Vdiq në qytetin Kuartre(Belgjikë). U varros me ceremoni në kishën e Kryqit të Shenjtë në Vjenë më 20 nëntor 1607.***

Ndërsa në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, botuar në 1985, emri i Gjergj Bastës përmendet pothuaj shkarazi në zërin "Stratitotët". Ja dhe pasazhi ku përmendet Gjergj Basta: "Stratitotët shqiptarë përbënin një armë shumë të shkathët e me efekt, e cila solli një ndryshim në artin luftarak të kohës, një përvojë që e përgjithësoi stratoti me origjinëshqiptare Gjergj Basta."****

Në Itali është botuar libri i studjuesit itailian Paolo Petta, me titull "Stradioti-ushtarët shqiptarë në Itali "ku në mënyrë të hollësishme jepen të dhëna të rëndësishme për stratitotët shqiptarë, në Itali. Është një libër i specializuar për këtë fenomen që karakterizon kryesisht shqiptarët e ku Gjergj Basta është një nga përfaqësuesit më kryesorë të stratitotëve shqiptarë në shek.XVI-XVII.²⁴

*** Akademia e Shkencave e Shqipërisë."Fjalor enciklopedik shqiptar"
Tiranë,2008,f.186

**** Akademia e Shkencave e RPSSH. "Fjalor enciklopedik shqiptar" Tiranë,
1985 , f.99

²⁴ Paolo Petta ."Stradioti-soldati albanesi in Italia" sec.XV-XIX,Lecce,Itali,1996

Një prezantim të shkurtër të këtij libri po e sjell në italisht: “Per migliaia di anni il mestiere del soldato mercenario è stato, in tutto il mondo, un mestiere onorato, e popoli interi – alcuni poi arricchitisi, come gli svizzeri, altri rimasti poveri, come albanesi, -lo hanno praticato, cercando in questo modo di trovare un loro spazio nel mondo dei ricchi. In Italia, migliaia di albanesi hanno seguito via, del XV secolo (se non prima) fino al XIX : si tratta di una emigrazione tutta particolare, che soprattutto nel Rinascimento si impara all’attenzione di tutta l’Europa per le fortunate imprese degli “stradioti”, cavalieri ondacissimi al servizio di Venezia, e poi di molti altri sovrani. Tra i discendenti di questi mercenary si troveranno, tra gli altri un Papa e un rivoluzionario illustre Antonio Gramsci.”

Lidhur me përcaktimin e krahinës së Himarës në shekuj vlen të citojmë përkufizimin që na dokumenton prof. Pëllumb Xhufi në studimin e lartëpërmendur “Stratitotët himariotë”:

“Himarë e nënkuptuar në shtrirjen e saj gjeografike që i përket këtij termi atë kohë, nga Tragjasi e Kuçi në Shën Vasil e Delvinë dhe nga deti Jon lumërrjedhjen Drino – Vjosa.” Koha për të ciën flitet është mesjeta e vonë dhe fillimet e jetës së re. Ky dokumentim është marrë nga studjuesi Cirillo Karalewskij në veprën e tij : “La missione Greco-cattolica della Cimerra nel Epiro” nei sec. XVI-XVII përfshirë në “Bessarione”,- Rivista di studi orientali-fasc.1 (1912)f.196

Përsa i përket vendodhjes së toponimit Bastje që përmenden në pak enciklopedi apo studime, ky emër është përdorur nga një autor i fillimit dhe të tjerët e kanë ndjekur duke zbatuar “fenomenin e dominos”. Fakti se jo të gjitha burimet nuk bien pre’ e këtij fenomei është shumë domethënës dhe lejon trajtimin shkencor. Për të pasqyruar vetëm disa prej tyre, mund ta fillojmë me faktin që ka të bëjë me vetëemrin e qytetit të Sarandës. Përgjithësisht emri i këtij qyteti – perlë njihet

Rëndësi ka fakti se Bastja ishte fare pranë Nivicës

nga emri grek “Ajos Saranda” që do të thotë” 40 shenjtorët” dhe kështu qarkullon ndër libra, studime e shumë gjëra të tjera. Sipas “Free Encliclopedia”, Saranda ka dhe një emër tjetër e që vjen nga koha e romakëve. Sipas kësaj enciklopedie ky qytet quhet “Forty martyrs of Sebastja” e përkthyer në shqip do të thotë “Dyzet martirët e Sebastjes”.

Si qëndron historia?

Historia e vendosjes së këtij emri ka të bëjë me një grup ushtarësh romanë të Legjionit të XII –të Fulminante (të ndriçuarit, ose të paisur me drita). Këta ushtarë janë vlarë afër qytetit të Sebastes, qytet që ndodhet sot në Turqi e që quhet Sivas. Faktikisht i ka takuar Armenisë antike.

Duke u bazuar në konkludime jo vetëm hamëndësore rezultojnë se Bastje është një zonë e gjërë rreth Sarandës, e ashtu siç thuhet për përfshirjen e fshatrave të Poshtëm të Bregdetit nën juridiksionin e saj , po ashtu dhe Nivicë-Bubari është fshati më i afërt me Bastjen (Sebastjen, Sarandën). Kështu që studimi i prof. Pëllumb Xhufit merr vlera të posaçme me atë informacion serioz për origjinën e familjes së Gjergj Bastës nga Nivicë- Bubari.Për këtë studim Prof. Xhufi është konsultuar me literaturë të kohës. (Simancas Estado Leg 1105; n54)

Shënim:

Fjala “sebastos” vjen nga greqishtja dhe do të thotë “i respektuar”.

Homines dum docent, discount
Ata që mësojnë të tjerët, mësojnë edhe vetë

PJESA E TRETË

Neofit Rodino

NEOFIT RODINO

Për bazilianin Neofit Rodino të paktë janë njerëzit që dinë për të. Natyrisht që kjo ka arsytet e veta , por dhe në në këtë rast vlen shprehja e vjetër se” gjërat kanë kohën e vet”.

Por ja që ndërkohë lindin dhe idera e botohen artikuj dhe pastaj libra ku flitet për historinë e shqiptarëve. Pa u futur në hollësitat dhe detajet për personin e misionarit Bazilian Neofit Rodino, të cilat do t’i japim rrjedhazi gjatë këtij studimi , dua të ndalem në një fakt konkret.

Është fjala për librin e LLambro Rucit me titull: ” HIMARA-zëra e Akrokerauneve”, botuar në Tiranë në vitin 2011. Nga vetë nëntitulli i këtij libri kuptojmë se kemi të bëjmë me rrëfime, përshkrime, dokumente dhe këngë. Por për një studjues të vemëndshëm ky libër i LLambro Rucit nuk është vetëm kaq.

Vladimir Kumi, kryetar i Komunës së Lukovës, me syun e një studjuesi këmbëngulës gjen se ky libër jep fakte të dokumentuara për historinë e gjuhës shqipe në fshatrat e bregdetit dhe për institucionet ku kjo gjuhë lëvrohej, duke trajtuar gjërësisht fshatin Nivicë-Bubar.

Pikërisht në Librin “Himara-zëra e Akrokerauneve “ ringjallet një nga figurat bazë dhe kryesore të problemit të shkollave të para shqipe në Bregdetin e Jugut, e veçanarisht në Bregdetin e Poshtëm, më saktë në fshatin Nivicë-Bubar, që sot bën pjesë në komunën e Lukovës.

Ka kohë që në mendjen time vinin ide për disa veçori paralelizmi të fakteve historikë që kanë të bëjnë me Nivicë-Bubarin dhe për fshatrat pranë tij si Shën-Vasil dhe Lukovë, ndoshta dhe ndonjë tjetër. Nuk është fjala as për trimëritë e kapedanëve me emër niviciotë në rrjedhën e viteve e të shekujve, as për qëndresat masive të fshatarëve niviciotë kundër çdo lloj

uzurpatori, as për këngët e bukura e origjinale polifonike e as për fenë aq të konsoliduar në mënyrë krejt origjinale. Eshtë dhe një veçori tjetër po kaq me vlera të mëdha historike.

Në skicën time “Ese për babain tim” botuar në vitin 2008 unë e shpreha shkurtimisht këtë veçori ndryshe të fshatarëve të Nivicë–Bubarit e fshatrave për krah ku në një fragment shkruhet: “Po siç ishin kohët atëhere, kur s’para thuheshin shumë gjëra nga frika e regjimit, nuk mund të mësoje se fshatarët e Nivicë–Bubarit me pjestarë edhe nga fisi im kanë shkuar në Leçe të Italisë më 1615 për mardhënie zyrtare tregtare.”

Ndoshta babai nuk e dinte këtë histori që u zbulua vetëm mbas vitit 1991, në Universitetin e Leçes. Ai ndoshta nuk e dinte se një pjesë e fisit tonë diku është përhapur në brigjet përkarshi, në Italinë e Jugut. Shumë gjëra nuk diheshin, por dhe ato që diheshin, nuk fliteshin. Sot rezulton që fshatarët e Nivicës dhe të gjithë bregdetit të jugut qenë lidhur më shumë me Italinë se sa me Greqinë, në shekuj.”²⁵

(Dokumentat dhe të dhënat në internet vërtetojnë se në komunën e Zollinos, provincë e Leçes, ka banorë me mbiemrin “Minguli”, shih dhe protocollo@comune.zollino.le.it)

Për hir të së vërtetës këto fakte mund të kenë qenë të menduara por kurrë të analizuara në librat e autorëve shqiptarë apo dhe në përkthime nga gjuhë të huaja që rrokin këtë problem. E gjithsesi këta fshatarë jetonin të lirë në çdo kohë.

Dëshiroj të citoj një fragment nga libri i Spiro Meles, për atë periudhë që ishin nën vartësinë e pashait të Delvinës: “Himarjotët, populli dyfekut, kishin arritur gjer më atë kohë, vetëm me trimërinë e vet të mbanin të papërlyer fenë e tyre, autonominë e plotë dhe të gjallë ndjenjën e lirisë.

Fshatrat e tyre të bukura, që zbardhonin mes rrëzëmave të Akrokerauneve dhe detit, Aj-Vasili, Nivica, Sinica, Lukova dhe të tjera ishin sa për formë nën pashain e Delvinës, por në realitet ishin të lira.”²⁶

²⁵ Gazeta “Bulevard” Durrës, 7mars 2008, Fatmir Minguli:-ese për babain tim

²⁶ Spiro Mele.” Luani i Epirit, Ali Pasha dhe Suli ”- botim Biris, Athinë, 1972

Intermexo nr 3

Para se të njihemi me jetën dhe veprimtarinë e misionarit të parë bazilian në Nivicë –Bubar le të njihemi me këtë paragraf nga libri i studjuesit italian Nilo Borgia:

“...Duke lënë mënjanë të parin, që hapi Misionin, Neofit Rodinon, njeri i ditur shumë i zellshëm dhe vërtetë apostolik, të tjerët që janë dërguar për ta mbajtur, gjersa filloi t’u delegohet drejtimi i murgjëve bazilianë, kanë qenë grekë levantinë, për më shumë të ikur nga Greqia dhe të rritur në Romë, të cilët, për mungesë diktrinarie dhe të zellit, kanë shkatërruar me shembullin e tyre të keq sesa kanë ndërtuar, ashtu siç kujtohet akoma aty.”²⁷

Është për tu vërejtur një fakt i rëndësishëm që flet për personalitetin e madh që ka patur Neofit Rodino jo vetëm në Qipro por dhe në gjithë Europën e atëhershme. Studimi që një grup studjuesish në Universitetin e Padovës, Itali ka bërë në vitin 2008, hapet me një thënie brilante të Neofit Rodinos:

“Është vepër e mirë, e në se nuk gaboj, është më e mira, që në vend të ndërtimit të piramidave, kullave, teatrove apo ndërtimeve të tjera, që janë pre e tërmetejeve, rrënimeve të kombeve, dhe katastrofave të tjera, shënohet vetëm për ata që banojnë afër apo larg, libri, i çfardo forme qoftë ai, si një zog shkon kudo, në Lindje dhe në Perëndim, dhe ekziston gjithmonë, e koha që shkatërron shumë gjëra, nuk mundet, siç thotë miku i Qipros, Isokrati, të arrijë që asnjë gjë të mos harrohet”.²⁸

Misionarët basilianë fillimisht ishin unitë me prejardhje greke, pra që nuk njihnin shqipen, siç ishte rasti i Neofit Rodinos, me origjinë qipriote. Sipas asaj që shkruan Rodatoja për Rodinon:–“ ishte i pari themelues dhe drejtues i misionit në këtë province.”²⁹

²⁷ Nilo Borgia – “I monaci Basiliani d’ Italia in Albania”, Roma 1942, f. 166

²⁸ Università degli studi di Padova, Facoltà di lettere, Dipartimento di storia –“Il Regno della Repubblica, Continuità istituzionali e scambi interculturali a Cipro, durante La dominazione veneziana (1473 – 1570 0, 31 janar, 2008 - paduareserch. cab.unipd.it/

²⁹ Llambro Ruci, Vepër e cituar, f. 16

JETA E NEOFIT RODINO

Jeta e misionarit qipriot bazilianit Neofit Rodino është pak a shumë e uniformizuar nga autorë të ndryshëm. E quaj të udhës që të mbështetem më shumë te artikulli i Dhimitër Shuteriqit që është botuar herët në vitin 1963. Është e rëndësishme të theksoj se ky artikull është konfirmuar nga studjuesi italian Aristide Brunello, studjues që ka mbrojtur doktoraturën për Neofit Rodinon. Gjithashtu dhe studjuesi shqiptar Jup Kastrati, tek shkruan për shkollat e para shqipe, studimin e Dhimitër Shuteriqit e quan tepër të rëndësishëm.

Neofit Rodino ka qenë murg bazilian me origjinë nga Qipro. Familja e tij , që sipas dhe mbiemrit rridhte nga Rodi , ishte vendosur në Qipro ku Neofiti lindi në 1576 apo 1577. I jati Solomon Rodinoi , zoograf dhe vjershëtor ,mori pjesë në luftimet për mbrojtjen e Nikosisë kundër turqëve, në 1570-1571 dhe mbahet mend për një vepër poetike ku subjekti kish të bënte me këtë ngjarje.

Pas studimeve fetare në Qipro dhe Kretë, Neofiti ndoqi në Venetik mësuesin e tij të njohur Maksim Murguinjosin. Ka shkuar aty pas vitit 1599 deri në vitin 1607 ku është kthyer në katolik.

Në vitet 1607-1610 ndodhet në Romë si nxënës në kolegjin grek të Shën Athanasit ku formoheshin misionarët e Vatikanit pranë ortodoksëve. Studjon filozofinë dhe teologjinë në Universitetin e Salamankës ku ishte dhe lektor i greqishtes në vitet 1610-1616. Më pas shkon në Poloni ,ku bëhet murg dhe shërben tre vjet në vende të ndryshme të lindjes.Dhimitër Shuteriqi thotë se ndoshta në vitet 1610-1616 ka qenë në Janinë.

Ndërsa në vitin 1621 - 1625 ka qenë në Mexojuso.

Ndërsa në vitet 1621-1625 ka qenë ndër arbëreshët e Mexojusos Siçili. Në 1627 - 1625 ka qenë mund të jetë kthyer prap në Janinë. Në këtë kohë ka vizituar dhe

Himarën ku hapi paraprakisht një shkollë, e duke u larguar me premtimin se do të kthehej prap. Shkoi përsëri në Mexojusos dhe hapi edhe aty një shkollë. Në periudhën e viteve 1628-1643 me interval kohe, hapi misionin e Himarës ,megjithëse gjatë kësaj periudhe shkon shpesh në Itali. Në vitet 1631-1633 shkon në arbëreshët e Potencës , në koloninë e Barilas, qëndron aty për arsye të ndryshme si mungesa anijesh për transport apo diçka tjetër. Nga Himara largohet në vitin 1648 dhe vendoset në Leçe të Italisë e më tej në Napoli, ku shërbeu si prift i kishës greke dhe mësues i greqishtes në gjimnaz. Nga fundi i jetës, në 1656 kthehet në Qipro ku dhe vdes në vitin 1659. Në këtë përshkrim të shkurtër, natyrisht që nuk del e plotë jeta dhe vepra e Neofit Rodinos.

E rëndësishme është se kur Rodinoja ka ardhur në Himarë ka gjetur priftërinj shqiptarë që dinin të shkruanin shqip. Pa tjetër njëri është prifti Dhimitër Dervina për mbiemrin e të cilit Dhimitër Shuteriqi ka ngritur pikëpyetje. Ky At Dhimitri që përmendet shpesh nëpër faqet e librave të studjuesve të huaj, kryesisht



Shkolla e re në Nivicë Bubar

fqinjë si italianë, grekë del në pah në veprën e Edwin E. Jackues, “Shqiptarët”, pjesa e I-rë, me nëntitull “Shkollat e hershme katolike”, ku ai shkruan:

“Shkolla e parë e dokumentuar shqipe u hap në Velje të Mirditës në1632. Të tjerat Pllanë 1638, Shkodër 1698. Mësuesit: Gjon Shqiptari, Filip Shkodrani, Dhimitër Dhërmiu etj...”³⁰

Në një shkrim studimor nga Ndue Ukcama, flitet për shkollat e para shqipe në Veri të Shqipërisë. Në këtë studim ky autor vëren: At Donat Kurti , në një studim të rrallë të botuar te “Hylli i dritës”, në Shqipërinë veriperëndimore shkruan:-Një tjetër shkollë mjaft e hershme ishte hapur në Kurbin, në 1632. Përveç shkrimit e leximit aty mësohej gramatikë shqipe dhe përdroreshin librat e Bardhit, Budit dhe Bogdanit-. Thelbin e vërtetë të këtyre shkollave e jep bukur kleriku fraençeskan shqiptar Leonardo, i cili pohon: “Ne jemi më shumë misionarë për qytetërimin se sa të fesë.”³¹

Kështu, rezulton shumë i rëndësishëm fakti shkencor që na jep Llambro Ruci , ndryshe nga shumë studjues të tjerë shqiptarë: “Përktimi i Doktrinës së Krishterë në shqip e lidh emrin e ndritur të Papa Dhimitrit nga Dhërmiu me shkollën e shenjtë shqipe në Himarë.Dhe padyshim edhe me emrin e Mësues Rodinos, një misionar vizionar e pa paragjykime, që i njohu mirë dhe i deshi himarjotët, një shkrimtar me shumë vepra të vyera fetare, me një gjuhë të gjallë popullor i cili i jepte përparësi shkollimit se sa meshimit, qoftë dhe në ritin unit.”³²

Duke bërë një analizë të vogël në krahasimin e shkollave shqipe të hapura nga katolikët e Romës në Shqipërinë veriore dhe atë Jugore shohim se koha pothuaj është e njëjtë, sipas dokumentave, rreth vitit 1630. Por shohim një ndryshim në literaturën shqipe të përdorura në këto shkolla.Nëse në veri përdroreshin librat e Budit, Bardhit, Bogdanit, në Jug praktikohej përktim më vete i Doktrinës së Krishterë. Kjo tregon se gjuha shqipe në jug ka qenë e praktikuar

³⁰ Edwin E. Jackues, “Shqiptarët, pjesa I, Tiranë, 1996.

³¹ Ndue Ukcama, “Kurbin e Lezhë, 380 vjet histori e arsim kombëtar, Gazeta “National”, Tiranë, 11 nëntor 2012.

³² Llambro Ruci, Vepër e cituar, f.184

me priftërinj vendas apo të mësuar nga priftërinjt arbëreshë, si rasti i priftërinjve të Mezojusos në arbëreshët e Siçilisë e që kanë ardhur e kanë shkuar midis dy brigjeve përballë siç është rasti i At Dhimitrit nga Dhërmiu. Në të dy rastet e mësipërme priftërinjt kanë ditur shqip në të folur e në të shkruar. Por lind një pyetje.

Përse Neofit Rodinoja i ka ngarkuar At Dhimitrit të përkthejë në shqip Doktrinën e krishterë? Mos vallë ai nuk e dinte se katolikët françeskanë të Veriut përdornin përkthimin nga Pjetër Budi në Romë! Këtu besoj se më shumë se argumentat e dhëna nga studjues të ndryshëm si psh, problem i alafabetit latin në përkthimin e Pjetër apo dialekti geg i shkruar në këtë vepër të rëndësishme, mbeten për t'u diskutuar.

Në këtë kopertinë paraqitet një qiparis, krejt i ngjashëm me qeparisin që ndodhet në brendësi të fshatit Nivicë Bubar.



Tabela e shkollës së Nivicë - Bubar



Kopertina e librit të Neofit Rodinos

Një vlerë të veçantë në këtë përcaktim kohor të veprimtarisë së klerikëve të dërguar nga Roma si misionarë, merr dhe studimi i Dr.Kristaq V. Jorgjit "Misioni imurgjësive bazilianë në Himarë, Faza e I-rë ", ku jepet në mënyrë të detajuar koha kur kanë filluar dhe kur e kanë mbaruar misionin e tyre në Krahinën e Himarës.³³

Kështu, i jepet vëndi i duhur dhe njohja e meritave të misionarëve bazilianë ,e në veçanti Neofit Rodinos, në aspektin e shkrimit të gjuhës shqipe dhe shkollave shqipe në Bregdetin himariot gjatë shekujve XVII-XVIII.

Sqarohen në këtë mënyrë dhe ato shkrime që janë botuar për misionarin katolik Nilo Katalani si ndër të parët e atyre misionarëve bazilianë që hapën shkolla shqipe në bregun e Jugut. Edhe pse në studimet e shumta për Himarën³⁴ citohet shpesh herë libri i Nilo Borgia-s, edhe pse në shkrimet e librat të ndryshme shkruhet për shkollat e para shqipe apo për kontributin e Nilo Katalanit në Dhërmi, kryesisht nga studjuesi Moikom Zeqo³⁵, përsëri mbeten ngjarje e persona që nuk theksohen në tonalitetin e duhur.

Sipas studimit të Dr.Kristaq V. Jorgji, të përmendur më lart, Nilo Katalani është misionari bazilian, i teti sipas rradhës që zbatonte Propaganda Fide në Romë. Edhe ky misionar sipas Moikom Zeqos predikonte shqip përveç se në Dhërmi, edhe në fshatrat Dukat, Shën Vasil, Nivicë, Tërbaç, Kuç, Zhulat. Më poshtë jepet një listë rendore e veprimtarisë kohore të misionarëve bazilianë në fazën e parë (sipas studimit të Dr. Kristaq V. Jorgjit, cituar në këtë studim)

Pavarsisht disa mungesave apo ndonjë pasaktësie kjo listë është bazale për studime nga më të ndryshmet. Kështu rëndësi të madhe merr kjo listë për sa i përket rolit të secilit misionar në krahinën e Himarës. Sipas kësaj table nuk mund të aludohet apo

³³ Dr. Kristaq V. Jorgji. "Misioni i murgjeve bazilianë në Himarë" - Konferenca e III-të pan-himariotë "E kaluara 2600 vjeçare - një thesar për të ardhmen.

³⁴ Himara në shekuj" - Akademia e shkencave - Tiranë 2004

³⁵ Moikom Zeqo. "Niko Katalani dhe shkollat e hershme shqipe të Himarrës" <http://ref100.co.cc/MHk1Ia>

FAZA E PARE E MISIONIT

Nr	Emri dhe Mbiemri	Viti i lindjes dhevdekjes	Periudha e qëndrimit në mision
1	Neofit Rodino	1575/6-1659	Fund korriku1628-nëntor 1642
2	Simon Laskaris	?	Fund 1657- fillim 1661
3	Andrea Arcedio Stanila	1637-1697	Fund 1660- 1685
4	Onufër Constandini	1634 -1717	1661-1665
5	Giovanni Crisafida	?	Maj 1663
6	Giovanni de Camillis	?	Maj 1668- 1672
7	Giona Corinto	1672-1685	?

FAZA E DYTE E MISIONIT

8	Nilo Catalano	1637- 1694	1693-Maj 1699
9	Filoteo Zassi	1654-1726	1693-shkurt 1715
10	Callinico Grana	?	Fund 1657- fillim 1661
11	Lorenzo Mariotti	?	1693- 1705
12	Basilio Matranga	1748	Shkurt 1715 – Gusht 1721
13	Giuseppe Schiro	1690 -1796	1718 – 1729
14	Lorenzo Guzetta	1730 - 1732	?
15	Giona Corinto	1730 -1732	?

të jepen mendime studimore të bazuara në hamëndje.

Në mënyrë të veçantë për zonën religjioze të fshatit Nivicë – Bubar vlen të konsultohesh pikërisht me kronologjinë e kësaj liste. Studjuesit e ndryshëm për çështjen e shkollave të para shqipe në mbarë Shqipërinë dhe veçanarisht në atë të jugut, përveçse kanë bërë studime të mirfillta për situatat e mësimit të gjuhës shqipe në krahinën e Himarës, kanë studjuar edhe influencën e të dërguarve të Romës në këtë krahinë. Kanë ndriçuar njëkohësisht edhe fakte shumë të rëndësishme për mbarë historinë e shkollës shqiptare. Por nuk mjaftojnë faktet dhe studimet hulumtuese për këtë problem kaq themelor për etnicitetin e shqiptarëve dhe ruajtjen e tij ndër shekuj. Studjuesi Josif Papagjoni shkruan se “Bregdeti ka pasur për tre shekuj shkolla shqipe, të njëkohëshme me shkollat shqipe të çelura nga Bogdani dhe Budi në Shqipërinë e Veriut, shumë shekuj më parë sa të çelej shkolla shqipe në Korçë, e quajtur gabimisht “shkolla e parë shqipe”³⁶. Ky fakt i pohuar na çon indirekt nga autori në fjalë me atë që ka të bëjë me vetë misionarin Neofit Rodino dhe fshatin Nivicë Bubar dhe shkollën e hapur aty. Në se shkruaj se LLambro Ruci “ndriçoi” një fakt, arsyeja është se ai është mbështetur fort në dokumenta serioze dhe të huaja dhe jo vetëm të Nilo Borgias, siç kanë bërë shumë autorë të tjerë.

Pa dyshim, se i pari ndër studjuesit shqiptarë, që ka përmendur faktin se Neofit Rodino ka qënë në Nivicë Bubar, është Dhimitër Shuteriqi i cili e ka shkruar në një studimin e vet të vitit 1963. Para se të theksoj rëndësinë e shkrimit të këtij historian të mirfilltë, po jap një pjesë nga shkrimi i tij:

“....Ai qe protagonist dhe polemist i fortë, shkroi shumë vepra, nga të cilat një pjesë u botuan. Një libër i tij i shtypur në Romë më 1659, Letër Johanit, Prethbiterit të Paramithisë, i datohet prej Nivice, 10 janar 1648.”³⁷

Ndërsa, faktin që Rodinoja ka shkruar një vepër në Nivicë –Bubar, apo dhe dy të tilla e njohim më poshtë:

Ndër veprat që Rodinosi shkroi në Himarë(Nivicë) (G.Valeta,

³⁶ Josif Papagjoni “Shtegut të vendlindjes” vëllimi 1,Tiranë 2009 f, 10.

³⁷ Dhimitër Shuteriqi.-Shkrimi i shqipes dhe shkollat në bregdetin himariot gjatë shek. XVII-XVIII.Botuar në gazetën “Mësuesi” datë 23 qershor 1963 dhe 5 korrik 1963.

Neofitos Rodinos, prozë popullore qipriote” (Hyrja)Athinë 1979), përmenden dy:

1.Apokrisis (Përgjigje), faqe 132, u shtyp në Romë më 1659 nga shtypshkronja e Propagandës dhe pastaj latinisht shkruar me miratimin e Leon Alatios. Në faqen e dytë përsëritet latinisht titullin e librit. Në fund ka vitin dhe dhe vendin ku është shkruar : *Nivicë, 1648, muaji janar.*

2.Shkurtesë mbi shenjtoret ekumenikë dhe veprën e sinodeve vendore, shkruar më 1645 -164, gjëndet në Biblotekën e Vatikanit dhe është shkruar në gjuhë thjeshtë greke “për nxënësit e tij Mathia, Spiridhon dhe Dhimitri”nga Delvina e Shqipërisë. Referimi i parë në të bëhet veprës së tij **Apokrisi**, që është shkruar më 1648 në Nivicë.”³⁸

Por nuk mjafton me kaq fakti për Nivicë-Buabrin. Është vetë autori Llambro Ruci që e quan Neofitin si “Rodinosi i keqkuptuar” dhe shënon më tej:“Për veprimtarinë e shënuar të Rodinosit, i cili, siç u përmend, Vunonë e kishte seli të zakonshme dhe qytetin e Himarës, qendër kryesore të rrezatimit misionar drejt vendeve dhe fshatrave të tjerë , po ashtu dhe Nivicën me manastiret për rreth e qark, nga me siguri do të ketë zgjedhur edhe ndihmës nga nxënësit e tij (papa Dhimitrin, apo murgj), ka interpretime të ndryshme.”³⁹

Jam i bindur se ardhja e misionarit të parë bazilian në Nivicë –Bubar për të predikuar,për të bashkëpunuar, për të shkruar vepra të rëndësishme për kohën e që janë botuar nën kujdesin e Selisë së Shenjtë nuk është një rastësi. Shprehja e Llambro Rucit “...Nivicën me manastiret për rreth e qark...” është një shprehje bazale të cilën duhej ta kishin kapur studjuesit e specializuar me kohë. A nuk është manastiri i Kakomesë një qendër e shenjtë dhe një qendër studimore për kohën, gjë që e vërteton bibloteka e pasur që gëlonte brenda mureve të fortifikuara të saj?! Po Manastiri i Krorëzës kaq pranë fshatit Nivicë– Bubar dhe vetë Manastirit të Kakomesë a e ka një kuptim të caktuar sipas kohës që është ndërtuar? Dihet që Manastiret nuk ndërtoheshin vend e pavend,

³⁸ po aty

³⁹ Llambro Ruci ,vepër e cituar ,f.170-171

jo vetëm në rajonin e Sarandës që është plot e përplot me objekte të kultit por për gjithë zonën mesdhtare. Të mos harrojmë se dhe hebretj kishin ndërtuar Sinagogën e tyre në qendër të Sarandës.

Paraqitja e këtyre përshkrimeve të manastireve apo objekteve të tjera të kultit nuk ka për qëllim zbehjen e veprimtarisë të misionarëve bazilianë në zonat e tjera, por ngulmon në faktimin e arsyes që Neofit Rodino e ka shkruar veprën e tij të dytë pikërisht në shkollën apo kishën e vogël në qendër të fshatit Nivicë-Bubar.

Ardhja e Neofit Rodinos në Himarë nga Spanja nuk është e rastësishme. Lëvizjet e negociatorëve si nivicioti Dhimitër Basta dhe prifti lukoviot Gjon Klosi në vizitat e tyre në Spanjë, ndoshta të herëpashërëshme i kishin dhënë rast Misionarit të Romës të njihej me atë krahinë në Jug të Shqipërisë e që njihej si Epiri i Sipërm.⁴⁰

Edhe Th. I. Papadhopullos jep një mendim të përgjithshëm , por gjithsesi ngacmues: “Nga disa botime të veçanta, mendohet se Rodinoja, pas endjeve të tij në Spanjë, u dërgua nga kisha katolike në Himarë në janar 1628. Por fillimi u bë një trevjeçar më parë, si dukej me interesimin e oborrit spanjoll të mbretërisë së Napolit, rivaliteti të cilit me venedikasit për zotërimin e krahinës, ekzistonte që më parë.”⁴¹

Pa e nënvleftësuar këtë pohim të autorit grek, mendoj se një arsye e fortë e ardhjes së Neofit Rodinos në Himarë dhe veçanarisht në Nivicë lidhet para së gjithash me influencën dhe popullaritetin që gjeneralizmi Gjergj Basta ka patur në mbretërinë spanjolle.

Prandaj kisha katolike dërgoi Neofitin si një personalitet jo vetëm të bazilianëve por si një erudit të jashtëzakonshëm ,shkrimtar me shumë libra dhe mësues i shkëlqyer. Se fare mirë mund të kishin dërguar dhe një misionar të thjeshtë. U desh shkuarja e Neofitos në Manastirin e arbëreshëve në Mezojuso që Propaganda Fede të hapte një kanal të ri të misioneve të saj katolike ndryshe nga ato që aplikonte në Veriun e Shqipërisë.

Po kështu pa u vlerësuar ka mbetur dhe Kisha e Peshkëpisë

⁴⁰ Llambro Ruci, vepër e cituar, f. 181

⁴¹ Thoma I. Papadhopullos Misioni I Himarës, Kontribut në historinë e Epirit të Veriut (shek 17- 18) Athinë 1988.

e cila nuk është se i përket thjeshtë një emri të një shenjtë , por ajo kishë ka qenë Episkopale , çka tregon që rrezatimi i saj ka qenë tepër i madh. E si mundet që një klerik me origjinë qipriote që kishte greqishten gjuhën e vet të ngrinte dy shkolla në dy fshatra që ishin me popullsi vetëm shqipfolëse?! Natyrisht që krahas greqishtes ka qenë dhe shqipja e kultivuar vazhdimisht në ato kohë jo vetëm kur erdhi Rodinoja por dhe më vonë, siç dokumentohet në shkrime të ndryshme.

Dhimitër Shuteriqi ka qëmtuar këtë pasazh nga shkrimet e Neofit Rodinos:“ më 28 gusht 1631 Rodinoi i shkruan kështu eprorit të Propaganda Fide – s në Romë: “Në studentët e tjerë që kam është një prift me emrin Dhimitër, që e di gjuhën shqipe në mënyrë shumë të zhdërvjelltë, meqenëse është i atij kombi dhe katolik i vërtetë; për këtë arsye, i hyra përkthimit të Doktrinës së Krishterë, që jepet në këtë gjuhë vetëm në dy vëllime e që besoj në Jezu Krishtin, se do t’u vlejë atyre. Do t’ua dërgoj më vonë, shpresoj së shpejti, meqë ende nuk e kam për t’a botuar.”⁴²

Ja se si e trajton me mjaft finesë dhe argumentim shkencor autori LLambro Ruci këtë dukuri :

“Siç kemi sqaruar edhe më sipër, Neofit Rodinosi ka vepruar kryesisht në Vuno (shqipfolës), ku kishte selinë e zakonshme, si dhe në Himarë (greqishtfolëse) në Nivicë (shqipfolëse), ku ka shkruar të paktën dhe dy vepra të tij, sipas shënimeve në to. Po dhe synimi i misionarëve bazilianë ishte të grumbullonin nxënës, nga të gjitha fshatrat për rreth e më larg disa ditë larg, të krishtera apo të myslimanizuara, fëmijë shqipfolës apo greqishtfolës, pikërisht duke e ditur se katolicizmi mund të rrënjosej me njerëz të ditur të vendit , që nuk ishin lidhur me një shërbim disavejçar të detyruar për hir të karrierës nga Roma në një provincë me aq vështirësi e rrezikje edhe të jetës. Nuk duhet se dhe liturgjia, që zhvillonin misionarët romanë në Himarë, siç kemi theksuar më sipër, ishte në greqisht, në dallim nga meshimi i katolikëve në Veriun e Shqipërisë.”⁴³

Në vijim të këtij arsyetimi kaq të pastërt po ky autor i bën

⁴² Dhimitër Shuteriqi – “Misionarët bazilianë në Himarë – hapja e shkollave greke në Himarë” – Shkrimi i shqipes dhe shkolla në bregdetin himariot gjatë shekullit XVII – XVIII – Gazeta “Mësuesi “në dy numura ; qershor 1956 dhe korrik 1956

⁴³ LLambro Ruci, vepër e cituar, f.206

vend të hapur fakteve që akademikë të ndryshëm shqiptarë i kanë anashkaluar. Fjala është gjithmonë me argumentimet dokumentare të funksionit të shkollës së Nivicë Bubarit ndër shekuj:

“Në librin me përmbledhje të veprës së tij (Neofit Rodinos F.M.)përgatitur nga G.Valetas (“Neofit Rodinos,Prozë demotike qipriote, Athinë 1979”),në parathënie jepet një pasazh mjaft interesant që lidhet me **shkollën e Nivicës dhe me karakterin e klerit rreth e rrotull:**

“Mësues në rajonet akrite.

E panjohur në biografinë e tij dhe në historinë e arsimit tonë mbetet shkolla që hapi Rodinos më 1648 në Nivicë të Shqipërisë. Duke dhënë mësim atje,vërtitej dhe nëpër manastire që të ngrinte kurse mësimore ,por gjeti shumë kundërshti .Për shkollën akrite të Nivicës flet dhe vetë në një kujtim të tij:

...Ditët e shkuara ,duke patur pak kohë të lirë nga shkolla,që në këto vende e mbaj mirëbërësisht për Mbledhjen e Shenjtë ,e cila kujdeset se si të rritet besimi i krishterë , Shkova në disa manastire ,që janë këtu për rreth dhe na njohin dhe e dine se mësohet pa asnjë pagesë. Dhe u thashë shumë atyre Etërve ,u paraqita shumë nga Shkrimi i shenjtë ,Etërit e Shenjtë ,mësuesit ,u thashë shumë mendime ,se kanë mungesë të madhe arsimore,prandaj të dërgojnë nga çdomanastir nga një a dy vëllezër që të mësojnë dikë ,se kanë nevojë të madhe dhe pikërisht për shërbimin e manastireve.

Ç’i them Hirësisë suaj ,bindeshin nga fjalët e mia ,vetëm se na shihnin përpara,por nga zilia e shumtë mes tyre:përse të mësojë ai e jo unë?Pse të studjojë ai e unë të punoj?...Nëse nuk kishin mësues e kishin detyrë ta kërkonin ,por e kanë dhe nuk e shfrytëzojnë. Mundim i padobishëm ,vreshta ara dhe pendë preferojnë në vend të diturisë dhe mësimi...Ç’e keqe është kjo?Nuk ka manastir që të ketë ndonjë njeri të arsimuar ,te i cili të rrëfehen dhe të ruajnë përcaktimet e kishës...të rrëfejnë të keqen dhe ta ndreqin nuk duan..⁴⁴

Pra dhe nga sa më sipër Neofit Rodinoja ka ndejtur në

⁴⁴ Llambro Ruci - vepër e cituar, f. 232-233

shkollën e fshatit Nivicë, në qendër të fshatit ngjitur me kishën, e pastaj ka kombinuar punën e tij me manastiret për qark fshatit Nivicë-Bubar. Është një traditë kjo e klerikëve italianë dhe atyre shqiptarë të veriut. Kështu një shembull ishte dhe famulltari i Mirditës Prend Doçi. Studjuesja angleze e paimagjinueshme për kohën, Edith Durham, shkruan për këtë prift mirditor:

”Qe shpikësi i një sistemi të shkëlqyer për të shkruar shqipen, me të cilin qëronte thekset e ndryshme dhe geramat e tepërta...” Ky famulltar erudit, i shëtitur nëpër botë, një nga pjesmarrësit e Lidhjes së Prizrenit, afër kishës së tij kish hapur një shkollë të vogël shqipe.⁴⁵

⁴⁵ Fatmir Minguli - “Kanuni i përkitur” f.58 Milosao - Sarandë

NEOFIT RODINO MËSUESI I PARË I BREGDETIT

Edhe në një letër tjetër që Neofit Rodino ka shkruar gjatë qëndrimit të tij në Bregdet shkruan:

“Jam kurdoherë midis malësorëve të mi të dashur, gjithnjë i zënë për t’i evangjelizuar dhe për të mësuar fëmijët e tyre”

Roli i Neofit Rodinos ka qënë tepër i madh dhe vepra e tij pati jehona që ushtuan për shekuj me rradhë jo vetëm në segmentin Himarë- Nivicë Bubar.

Joan (Giovanni) De Camillis, një misionar bazilian që veproi në Zonën e Bregdetit shumë më vonë se Rodinoja ,në një letër drejtuar një Ati shkruan:

“Kur morën vesh ardhjen time gjithë u gëzuan dhe nga shumë vise dërguan të më marrin dhe nisën të zihen nërmjet tyre që kush të më marrë: po unë s’u zë besë aq tepër se e di që janë të luajtur në punët e tyre, dhe kam shumë frikë që kur të mbaroj kohën mos them” mbolla mbi rërë “ sikundër tha Neofit Rodino, një nga më të diturit e më të mirët e njerëzet që ka nxjerrë shkolla jonë, si u mundua tetë vjet për të gdhendur këta njerëz, dhe si pa që kanë pak ngrohtësi për urtësi dhe për vetija të mira.”⁴⁶

Shumë kohë pas vdekjes së mësuesit Rodino në Bregdet u krijua Vëllazëria e që ishte nën mbrojtjen e Shën Dhimitrit dhe që me ndërmjetësinë e tyre u hap një shkollë e cila kishte zakon kremtimin me solemnitët të madh festën e martirit të madh. Siç duket ruheshin akoma traditat dhe kujtimet e at Rodinos në shpirtrat e këtyre malësorëve. Pra Rodino ishte mësuesi që me zellin e zgjuarsinë e tij nguliti jo vetëm në mendjet e tyre por thellë në shpirtra njerëzorë.

Sipas Nilo Borgias këtë shkollë dhe vëllazëri e themeloi Onofrio Costantini, misionari i katërt sipas rradhës që dërgonte Propaganda Fide në Misionin e Himarës. Kemi parasysh se ky misionar bazilian ka vepruar në krahinën e Himarës në periudhën 1661-1665, dmth rreth 15 vjet më mbrapa nga ikja e Rodinos.⁴⁷

Vlen të bëhet një përqasje midis emrit të shenjtit Dhimitri,

⁴⁶Revista“Kalendari Kombiar” e Lumo Skëndos ,f. 46-52, Sofje 1901

⁴⁷ N. Borxhia vep e cituar I, 1935 f 101, 102

kishës së Shën Dhimitrit që ndodhet në qendër të fshatit Nivicë Bubar dhe vetë nxënësit e Neofit Rodinos, Papa Dhimitri, prift që mbart një peshë të madhe në ngjarjet e atyre kohëve përpara se të shfaqej Rodino dhe pasi ai iku nga Himara apo Shqipëria përfundimisht, në 1649.

Rodatoja, një studjues i njohur, duke shkruar për Rodinon thotë: “Futi reformat e pafundme te këta popuj të ashpër dhe të mbushur me ndjekje besytnore të paganizmit. Sapo hyri vuri re që banorët kishin më shumë rreptësi se sa natyrë njerzore.

Nuk ndiqnin sakramentet, nuk dëgjonin as predikues , as shërbesat dhe shpërfillnin gjer formulën e pagëzimit. Mund të thuhet se nuk kishin veç një hije të turbullt dhe një skelet memec të fesë...

Veprimi i Rodinos nuk njohu kufi: në rrugët misionare, që pa përjashtim shtriheshin në të gjithë këto fshatra, vijonte më pas puna e vështirë, e përditshme e shkollës; nga shkolla, ajo më delikatja e rrëfimit, ajo e vizitave te të sëmurët, në manastiret e murgjëve dhe kudo për të lehtësuar, për të mësuar, për të tërhequr shpirtrat te Zoti.”⁴⁸

Eshtë shumë lehtë të kuptohet ky vlerësim i cili ngjan esencialisht me letrën që Neofit Rodino ka shkruar në kujtimet e tij për shkollën akrite të Nivicë Bubarit. Prandaj del në pah mendimi i theksuar disa herë nga studjues të ndryshëm se synimi i misionarëve bazilianë ishte të afronin e të grumbullonin sa më shumë nxënës nga fshatra të largët apo të afërt me qendrën e shkollave që Rodino hapi fillimisht në zonën e Dhërmiut dhe veçmas në qendër të fshatit Nivicë Bubar. Në këto shkolla, nxënësit ishin ose të krishterë ose myslimanë, shqipfolës apo greqishtfolës.

Detyra e misionarëve ishte e vështirë, duke marrë parasysh këtë larmi të prejardhjes së nxënësve, vështirësi që Rodinoja dhe më pas misionarët e tjerë e kanë kaluar me rezultate pozitive për kohën. Ata ishin të bindur se këto probleme jo të zakonshme që u kish besuar Propaganda Fide do t’i kapërcenin me sukses sepse ata ishin njerëz të përgatitur në shumë fusha.

Vlen të theksohen edhe mendimiet që parashtrojnë disa studjues nga Bregdeti në librat e tyre të përmendura në këtë studim

⁴⁸ Sipas Rodatos tek N .Borxhia , vep . e cituar .f,206

lidhur me një aspekt delikat dhe burim sjellës siç është zhvillimi i liturgjisë që kryhej në kishat e bregdetit që nga Vunoi deri në Nivicë. Sipas shumicës së tyre del që këto liturgji kryheshin në gjuhën greke, krejt ndryshe nga si zhvillohej në Veri të Shqipërisë.

Por nuk del e qartë nga literatura se cilët nga misionarët bazilianë me origjinë arbëreshe fliste dhe shkruante shqip, por fakti është se shumë misionarë bazilianë që u dërguan nga Vatikani ishin jo më kot me origjinë nga arbëreshët e Italisë Jugore. Ky është një nga çelsat zgjidhës të shumë problemeve për shkollat shqipe në Bregdetin e Jugut.

Vetë Neofit Rodino, një njeri i ditur dhe i dërguar në shumë vende të mbuluara nga katolicizmi papnor, çuditërisht para se të hapte misionin në Himarë në vitin 1628, është dërguar në vitet 1621-1625 ndër arbëreshët e Mexojusos në Siçili (në shqip-Munxifs), zonë ku ai shkoi prap në vitin 1627, dmth një vit përpara se të vinte në Himarë. Këtë herë të dytë ai hapi aty një shkollë. Dhe kur ai e ndërpreu misionin e Himarës, përsëri në vitet 1631-1633 shkon te arbëreshët e Potencës, në Barila ku qëndroi për një kohë të gjatë, që siç shkruajnë disa burime, qëndroi më shumë prej ndonjë sëmundje apo për mungesë anijesh. Ai donte të kthehej përsëri në misionin e Himarës. Me sa duket ai atje është njohur jo vetëm me jetën e arbëreshëve por, për mendimin tim dhe me gjuhën shqipe.

Në literaturën e specializuar që lidhet me kohën e qëndrimit të Neofit Rodinos në manastrin e Mexojusos, Antonio Fyrgos jep idenë se Neofit Rodino duhej të dinte shqip, gjë që e ndihmoi të hapë shkolla shqipe në Mexojusos dhe në Vuno dhe Nivicë-Bubar.⁴⁹

Prandaj, duke duke paralelizuar këto të dhëna, gjejmë se mësimi i gjuhës shqipe në krahinën e Himarës, duke futur dhe shkollën e Nivicë- Bubarit ku ka punuar Rodino, është e lidhur ngushtë me ekzistencën e Manastirit të Mezojusos në Siçili, ku kishte horizonte të gjëra për zhvillimin e mësimave dhe studimeve në gjuhën greke, shqipe dhe latine. Edhe N. Borxhia për Manastirin e Mexojusos shkruan: “Ajo që duket e sigurtë është se ambjenti i Manastirit, nga ku na shkruan dhe D. Atanasio Musachi, Patirca

⁴⁹ Antonio Fyrgos

di Ocride, ishte shumë i zhvilluar në njohjen e gjuhës greke e asaj shqiptare dhe propocionalisht në ritin me të cilin ishte lidhur ekzistenca e Manastirit.”⁵⁰

Kështu që Mezojuso ishte si një trampolinë për fillimin e mësimëve të gjuhës shqipe në krahinën e Bregdetit. Në shkollën e Nivicë Bubarit gjuha shqipe ishte e kombinuar me atë greke, fakt që vërtetohet me Relacionin e dytë të misionarit Schiro, botuar në vitin 1729 ku komentohet vepra e misionarëve para tij në krahinën e Himarës, ku shprehimisht thuhet:

“... Pëlqimi i popullit arrinte në pikën që t’u lejonte misionarëve që të jepnin mësim doktrinën e krishterë, në mënyrë që të përsëriteshin përmendësh në formë dialogu në sheshet publike në gjuhën greke ose shqipe; dhe në këtë mënyrë mësoheshin (edukoheshin) ëmbël dhe të rriturit, të cilët, të tërhequr nga kureshtja, dyndeshin të dëgjonin ushtrimin e devotshëm, kryesisht të afërmit dhe prindërit e fëmijëve...”⁵¹

Por në Manastirin e Mexojuzos sipas studimit të Pietro Di Marco mbi këtë Manastir thuhet se aty ruhej përdorimi i gjuhës shqipe. Por ata thonë se nuk mund ta konfirmojnë me siguri edhe për latinishten sepse edhe ata që shkonin nga ky Manastir në Shqipëri si misionarë në bregun e Himarës, rajon që ishte dygjuhësh, kishin edhe gjuhën greke. Prandaj sipas këtyre studjuesve duhet supozuar se disa flisnin shqip dhe disa flisnin greqisht. A nuk tregon kjo pak a shumë esencën e gjërave për ato kohë? ⁵²

Dhe çuditshëm gjejmë dhe emrin e të ndriturit Neofit Rodino “Vetë turqit jo me ndroje shkonin tek ai (Neofit Rodino) për këshilla e për të diskutuar, duke pritur e duke ditur që ai do përgjigjejnë gjuhën e tyre shqiptare.” – sipas –Archivio di Propaganda, Atti del 1694, Relazioni del Card. Prefetto E.mo Ottobani. Po ai që e sqaron fare mirë qëllimin e të shkuarit në Manastirin e Mexojuzos të Neofit Rodinos, është po ky autor, Pietro Di Marco :

⁵⁰ N. Borxhia, Vep. e cituar f,31

⁵¹ N. Borxhia, vep. E cituar, I, 1935, f, 4-5

⁵² Pietro Di Marco –Il Monastero di Mezojuso nella storia culturale arbëreshë-www.mediaevalsophia.net/

“Më pëlqen akoma të shënoj për shumë vepra që i takojnë Neofit Rodinos; ai ishte një murg bazilian nga më prodhimtarët si shkrimtar i madh grek në gjysmën e parë të shekullit XVII –të .Shkoi në Mezojuso i ftuar nga arkiveshki i Palermos Gianaettino Doria, për të hapur një shkollë për banorët e kolonisë shqiptare e ku mbeti për rreth dy vjet midis 1621 dhe 1625.”⁵³

Intermexo nr 4

Në nderim të fshatarve të Nivicë –Bubarit dhe të njerëzve të bregdetit poeti Moikom Zeqo është shprehur :

Poezia për Aleksandrin e Madh

Në kishën e shën Marisë në Atali të Himarës nën një afresk të skenës Ava Sisai të vitit 1795 është edhe kjo poezi:

Ορον σε ταφε / δύλεο σου την θεάν χ(αί) χαρδουστα /
λαχτων ομβρον εκχεό χρεος το κυνώ / βλυτων ης νουν λαμβάνο
πος γαρ δυελθο / πέρας βαβέ τηούτων ο θανα / τε της δύνατε
φυγην σε / ό Αβά Σησώ / εις / Αλεξανδρος ό βασιλεύς.

Përkthimi: Duke të parë ty o varr trembem nga pamja jote dhe derdh lot si shi, që pikojnë nga zemra, sjell ndër mend borxhin që është për të gjithë si do të kalojë deri në fund, o bobo nga kjo o i pavdekshëm kush mund të shpëtojë ty. Ava Sisoi – Mbreti Aleksandër.

Ava Sisoi është një asket shumë i famshëm. Skena e afreskuar e tregon shenjtin me duar të hapura dhe me brerore. Autori i poezisë mbase është piktori i afreskut Vasili, nga katundi Sinkriati, siç del nga mbishkrimi i bërë me dorën e tij në kishën e shën Marisë së Atalisë së Himarës me 10 prill 1795.

Shpenzimet për kishën e pikturuar janë bërë nga murgesha Zaharisa në kohën e peshkopit Joaniqi të Himarës dhe të Delvinës.Poezia e mësipërme është unike në kishat e Shqipërisë. Tema e përkohshmërisë së jetës njerëzore madje edhe e lavdisë së Aleksandrit të Madh shpreh kotësinë e jetës

⁵³ Po aty

tokësore dhe kultizon jetën hyjnore. Ava Siso si asket bën kështu një kundërvënie konceptuale me Aleksandrin e Madh, asketizmi është kështu më i fuqishëm se lavdia luftarake e strategut. Kemi në këtë rast edhe një sinkretizëm të pikturës me poezinë. Kjo poezi e shekullit XVIII është shumë interesante dhe antologjike. Shqiptarët e kanë njohur si paraardhës të tyre Aleksandrin e Madh.

Nuk kemi të dhëna të tjera për piktorin Vasili nga Sinkriati. Mundet që Vasili të jetë edhe autori i poezisë, ose ka dhënë në afresk poezinë e një tjetri, që s'ia dimë emrin.



Qiparisi shekullor në brendësi të fshatit Nivicë Bubar

*Indocti discant et arment
Meminisse periti*

Ata që s'dinë le të mësojnë ,
Ata që dinë le të gjejnë kënaqësi në kujtimet e veta.

PJESA E KATËRT

Meksi Buba

MEKSI BUBA

“ Një nga çështjet kryesore, që kanë tërhequr vëmendjen e albanologëve dhe të balkanologëve, është ajo që ka të bëjë me autoktoninë e etnosit arbëresh (shqiptar).

Të gjithë ata studjues, që janë ,marrë me historinë e këtij etnosi , e kanë prekur këtë çështje ,dikush drejt për drejt e dikush tërthorazi.Gjithsesi, një pjesë e tyre e kanë gjykuar të pamundur që etnosi arbëresh të ketë mbijetuar në trevat e tij të sotme qysh nga lashtësia greko-romake. Por siç e kemi shtjelluar gjërë e gjatë në një punim tjetër ***** , stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm mundën të jetonin në trevat e tyre në Ballkanin Perëndimor ,duke i bërë ballë romanizimit të plotë, natyrisht me një ndikim të fuqishëm të latinishtes mbi gjuhën e tyre.”⁵⁴

“Last but not least” –thonë anglezët- “ I fundit, por jo më i parëndësishmi ”. Kështu do ta emërtoja edhe këtë personazh të vërtetë të këtij libri. Faktet e të shkruarit të shqipes janë kokëfortë dhe të dokumentuara, por mënyra e të shkruarit ka qenë latine. Për këtë flasin dokumente si ky më poshtë: Arqipeshkvi i Antivarit, Guillelmus Adae më 1332 shkruan për gjuhën shqipe: “Ndonëse shqiptarët kanë një gjuhë krejtësisht të ndryshme nga ajo latine , ata përgjithësisht përdorin në të gjithë librat e tyre shkronjat latine”.⁵⁵

Por vetë bazilianët e Propaganda Fide çfarë bënë në mes të shekullit të XVI në bregdetin Jugor? Në kohën kur Neofit Rodinoja qëndroi në misionin e tij në Himarë, gjithmonë sipas Nilo Borgias

***** Sh.Demiraj .”Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmime në gjuhën shqipe. Tiranë, 1999.

⁵⁴ Akademia e shkencave e Shqipërisë- Shaban Demiraj -“Gjuha amtare në bregdetin jugor shqiptar gjatë shekujve” Tiranë 2004 f.241

⁵⁵ Fatmir Minguli.” Kanuni i përkitur” Sarandë, Milosao, 2010 , f.61

, ai, Neofiti mbante pranë një prift vendas, të quajtur Dhimitër për të cilin thotë se “e njeh shumë mirë gjuhën shqipe, sepse është i kësaj kombësie dhe është katolik i vërtetë.” Dhe pikërisht këtë prift shqiptar, ai e ngarkoi të përkthente shqip Katekizmin, që nuk e pa dritën e botimit, sepse nga Roma i erdhi përgjigja se “Doktrina e Krishterë” tashmë është përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe.⁵⁶ Kuptohet se është fjala për përkthimin e Pjetër Budit, botuar në Romë në vitin 1618.

RRETHANAT KOHORE TË VEPRIMTARISË SË MEKSI BUBES

Po kush ishte Meksi Buba të cilin e shoh në kontekst të vetë këtyre fakteve që ndodhin në Bregdetin e Poshtëm Shqiptar në shekujt XVI-XVII!? Figurën e këtij personaliteti do t’a zbulojmë gjatë analizave të paraqitura në këtë studim.

Paraprakisht, ja vlen të them se Meksi Buba duke qenë në krye të një delegacioni shqiptarësh nga Epiri, ishte nga Nivica në Epir, fshat pranë Sarandës dhe shkante në qytetin e Leçes për të paraqitur dokumente lidhur me një kërkesë të tyre. Meksi Buba e printe këtë delegacion në Leçe në datën 7 korrik 1615⁵⁷ i shoqëruar nga shqiptarë të tjerë të cilët janë:

Prifti Papa Joni Klosi
Dima Basta
Petro Blaku -nga Parga
Llazar Kreti nga Vunoi
Mengoli Glosi nga Lukova

Të dhënat me emrat janë dhënë nga studjuesi Halil Myrto për herë të parë në vitin 2001 në revistën Dyrrah, N 1 që botohet nën kujdesin e shoqatës “Pal Engjëlli” në Durrës. Siç shihet në listën e mësipërme figuron emri i priftit Papa Joni Klosi dhe emri i Dima Basta. Pas një shikim të kujdesshëm gjej se këta dy emra që

⁵⁶ N. Borgia, vepër e sipërme, I (1935) f.49

⁵⁷ Halil Myrto, Revista Dyrrah N1, 2001 “Dy dokumente te shek.XVII në arkivin shtetëror të Leçes me njoftime mbi historinë e Shqipërisë.” f.15

ndodhen në listën e delegacionit të udhëhequr nga nivicioti Meksi Buba, ndodhen dhe në grupin që shkoi në vitin 1608 në Spanjë për të kërkuar mbrojtje nga Mbretëria Spanjolle ku emrat e tyre sipas dokumentit janë Dhimitër Basta nga Nivicë-Bubari dhe prifti Gjon Klosi nga Lukova.⁵⁸

Pra nga viti 1608 deri në vitin 1615 ka patur aktivitete të ndryshme të personave të ditur e të zot që kanë komunikuar, tregtuar e negociuar me anën perëndimore të Europës. Sa për kujtesë i ati i Gjergj Bastës quhej Dhimitër siç e kam përmendur në kapitullin që i kushtohet teoricienit ushtarak dhe generalismus europian, për më tepër që Dhimitër Basta rridhte nga një familje fisnike në Epir. Por le të kthehemi te figura e Meksi Bubës i cili ishte i ngarkuar me detyrën e mëkëmbësit të përgjithshëm të provincës së Epirit i zgjedhur nga peshkopi i Epirit Heremia.⁵⁹

Është i njejtë peshkop që përmend dhe prof. Pëllumb Xhufi në studimin e tij "Stratitotët himariotë". Pra kemi të bëjmë me skena të historisë shqiptare me një epiqendër siç është fshati Nivicë-Bubar ku ndërthuren tre këto figura të rëndësishme për jetën e atëhershme. Vlen që të përmend faktin e trajtimit thatë të këtyre figurave deri tani. Për shembull përputhja e disa fakteve nuk mund të jepet me hamëndje, pa u bazuar në dokumenta serioze dhe mirë të verifikuara. Është një lidhje virtuale midis tre aktorve të këtij libri triptik të historisë nivicjote në shekujt e XVI – XVII – të. Spanja është si të thuash ndërlidhësja e këtyre heronjve dhe ngjarjeve që ata përjetojnë.

Në Spanjë Gjergj Basta me origjinë të familjes nga Nivica filloi të marrë lavdinë si luftëtar shqiptar me 200 kalorësit e tij po shqiptar e ku bëri emër në oborrin e mbretit. Në Spanjë shkojnë shpesh negociatorë bregdatas nga Nivica e nga Lukova për të

⁵⁸ Pëllumb Xhufi, vepër e sipërme, po aty.

⁵⁹ Halil Myrto, Revista Dyrrah N4, 2005 "La presenza dell'arbëresh e l'influenza dell'albanese moderno nel Salento: Storia e attualità". f. 10. — Il document fa notare una electia di Albanesi d'Epiro, cappeggiata da Alexi Buba "della Nivizza in Epiro" come vicarius generalis provinciae Epiri in spiritualibus et temporabilis, electus dal vescovo d'Epiro Heremia e da altri seniores e sacerdoti di quella regione.

kërkuar mbështetje të shumëanshme nga mbretëria e Spanjës. Nga Spanja niset misionari Neofit Rodino për të hapur Misionin bazilian në Himarë por që Neofiti e çoi në Nivicë, i influencuar pikërisht nga miqtë e Meksi Bubës që shkonin e vinin në Spanjë. Eshtë më shumë se një lidhje virtuale.

ASPEKTE TE MARDHENIEVE TE NIVICIOTEVE ME ITALINE JUGORE

Vetë studjuesi Halil Myrto që ka dhënë për herë të parë në Shqipëri, burimet e ngjarjes së delegacionit në Leçe të Italisë kryesuar nga nivicioti Meksi Buba, thotë se ky burim u zbulua për herë të parë nga studjuesi leçez S. Panareo më 1939 në librin e tij “Albanesi nel Salento” në “Rinascenza Salentina XVIII”, 1939, f.131. Ndërsa vitet e fundit, po nga qyteti i Leçes, G. Kirici e ka trajtuar më hollësisht këtë ngjarje në librin “Albanesi e Corfiati immigrati a Lecce”, në –Annuario 1995-1996, Liceo –Ginnasio G. Palmieri, Lecce, 1996, f.171-189. Janë pikërisht këta dy autorë italianë që kanë ditur të komentojnë dhe interpretojnë ngjarjet e arkivuara në letrat e dokumentara.

Kështu psh, nuk mund të themi që “Meksi Buba dinte të shkruante dhe të fliste shqip, vetëm pse dokumenti i paraqitur para noterëve të Leçes nga delegacioni shqiptar ishte shkruar shqip.”- siç shkruhet në ndonjë libër të kohëve të fundit. Ne kemi informacionin e servitur nga Halil Myrto dhe ku thuhet se “Meksi Buba del para noterëve leçezë me një autorizim (“patentë”) “ të shkruar në gjuhën e tij “, që mbante datën 7115 pas krijimit të botës (sipas llogaritjeve viti 1607-1608), të lëshuar nga peshkopi i Epirit, Heremia, dhe nga të tjerë klerikë e antarë të pleqësive të atyre anëve. Noterët leçezë e shikojnë dokumentin, duke patur të pranishëm si përkthyes priftin Andrea Luçe të kishës së rritit ortodoks në Leçe, dhe ja kthejnë përsëri Meksi Bubës. Ky pastaj njëzëri me gjithë delegacionin, kërkon të emërojë si konsull në këtë qytet, në mbrojtje të interesave të krahinës që përfaqëson, zotërinë e shquar leçez Pomponio Guarino, që kishte dhënë shumë prova në të kaluarën në mbrojtje të interesave të shqiptarëve.

Pomponio Guarino, në fakt njihet si “kapiten trim”, familja fisnike e të cilit përmendet në këtë zonë që nga shekulli i XII –të. Delegacioni në fjalë vë në dukje para noterëve leçezë se emërimi i këtij konsulli dilte i nevojshëm, sidomos për shkak të humbjeve që shqiptarët kishin pësuar kohët e fundit në tregëtinë

e tyre me bregdetin e Salentos ,dhe veçanarisht në trafikun e armëve ,që Lartësia e tij Mbreti i Napolit, u jepte atyre për luftën që bënin kundër “armiqtë të pabesë”. Ata insistojnë që konsulli i tyre të kishte në Leçe ato të drejta dhe privilegje që kishin konsujt e vendeve të tjera,të njejta edhe me konsullin e Venedikut.⁶⁰

Intermexo nr 5

Nivica dhe Qeparoi	Të luftonjë me Sulltanë,
Që në Pisk' e në Sarandë	Përveç nga Nivica thanë,
U mbush deti me karavë,	Duall' dy tre kapetanë.
Do të bënë imlaqë fshanë.	Dhe nga Qeparoja janë
S'm'u ndoth një djalë ' a një vajzë	Zunë luftë me sulltanë,

Vetë ky dokument flet për mardhënie të hapura me krahinën e Salentos si porta hyrëse në brigjet italiane përkarshi dhe jo në brigjet greke.Po kështu na jep informacion për emigrimin e vazhdueshëm të shqiptarëve të bregut jonian kryesisht në tokat salentine.Në mënyrë të veçantë marrim informacion për faktin e shqipes së shkruar dhe të përhapur jo vetëm në brigjet e Italisë por dhe në Mbretërinë e Spanjës. Dokumenti i mësipërm flet dhe për rolin e madh të klerit në bregdetin shqiptar dhe veçanarisht në zonën e Nivicë- Bubarit. Eshtë prifti Gjon Klosi nga Lukova me sa kuptohet që shkruan dhe flet shqip, po aq sa dhe kolegu i tij leçez, Andrea Luçe që shkruan e përkthen në shqip.

Eshtë interesant fakti që lëvizjet e shqiptarëve fisnikë nga Shqipëria e Jugut drejt brigjeve salentine kanë qenë të shumta ndoshta se ka qenë shumë afër brigjeve të atdheut të tyre. Kjo është një e dhënë me shumë vlera sepse tregon se në ato vite mbas shpërnguljes së madhe, eksponentë të familjeve të ndryshme shqiptare kanë bërë kthime të vazhdueshme në Shqipëri për të vazhduar luftën kundër okupatorit osman. Janë të pafund

⁶⁰ Halil Myrto,Revista Dyrrah N1 f.16

përpjekjet e tyre pranë kançelarive të ndryshme të Europës për të gjetur përkrahje në furnizim armësh, në asistime mbrojtëse etj. Edhe ngjarja me delegacionin shqiptar në Leçe, tregon më së miri këto fakte. Halil Myrto, duke u bazuar në dokumente të ndryshme konkludon se shumica e familjeve të pasura shqiptare të shpërngulura në Italinë e Jugut u bënë pronarë tokash e pronash të tjera.⁶¹

Po ky autor me autoritetin e një studjuesi serioz shkruan: "Në 1561 nuk kishte vend në rajon (Salento F.M.) ku të mos regjistrohej prezenca e shqipëtarëve."⁶² U bënë feudale të familjeve me origjinë shqiptare në S.Marzano, Roccaforzata, Copertino, Parabita, Nardo, Salignano, Depressa, Melpignano, Alessano, Castro, Mottola e qendra të tjera."

Pikërisht janë këta feudë fisnikë shqiptarë, të sistemuar me vite në tokat e Italisë së Jugut që bashkëpunojnë me shqiptarët e Bregdetit të Jugut për një seri çështjesh ku ndoshta më kryesorja ka qenë ajo e furnizimit me armë për të luftuar uzurpatorin, siç është dhe rasti ynë me delegacionin të kryesuar nga nivicioti Meksi Buba.

Po jo vetëm armët ishin objekte tregtare në tregtinë bilaterale midis Salentinëve dhe shqipëtarëve. Burime nga studjues të ndryshëm japin komente tepër interesante për këto mardhënie. Raportet tregtare duket që janë zhvilluar gjithashtu edhe për shkak të rrolit të raportit gjuhësor midis dy vendeve. Shqipëtarë të shumtë në Leçe në 1615, siç është përmendur, kërkonin një Konsull-Mbrojtës (Console - Protettore), tamam "Për vazhdimin e trafikeve të mallrave dhe për trajtimin e mirë në dyqane të ndryshme nga mëkëmbësi i mbretit i Provincës e sepse kanë

⁶¹ Halil Myrto, Revista Dyrrah N4, vepër e cituar, f.8 ku thuhet: "...Altre famiglie nobili d'origine Albanese nel Salento tra il XV-XVII secolo sono state: i Tocco, i Vrana Castriota, i Basta, i Biscia, i Leca, Spata, Stresi, Renesi, Busicchio ecc. Divengono i feudi delle famiglie d'origine Albanese S.Marzano, Roccaforzata, Copertino, Parabita, Nardo, Salignano, Depressa, Melpignano, Alessano, Castro, Mottola e altri centri." "Familje të tjera fisnike me origjinë shqiptare në Salento midis shekujve XV-XVII kanë qenë: Tokot, Vrana Kastriotët, Bastat, Bishajt, Lekajt, Shpatajt, Stresët, Renesët, Buzikët etj.

⁶² po aty, f.9

pasur shumë dëmtime.”⁶³

Po kështu një autor tjetër si Cosimo De Giorgio thotë që janë të shumta raportet tregëtare gjatë gjithë mesjetës midis Pulies dhe Shqipërisë, mbi të gjitha midis porteve të Brindisit, Otrantos, San Cataldos dhe Monopolit me portet e Shkodrës, Tivarit, Durrësit dhe Vlorës. Nga portet shqiptare hynin në Pulia :Lesh, dyll, lëkura lepuri, saftjan, mëndafsh i papërpunuar, farë liri etj.⁶⁴

Një tjetër misionar bazilian në Himarë, Xhovani de Kamillis më 1637, shkruan: “Këta njerëz janë dhënë shumë pas armëve dhe gjithë prokopinë e tyre armë e bëjnë. Janë të pamëshirshëm me armikun, shumë kryelartë, po shumë të butë e familjarë me njerëzit e tyre. Dhe kanë qaq shumë dhurata të natyrës, sa që po të kishin ndonjë qeveri me ligje të artit liberal, këta aspak nuk do të ishin pas nga shumë kombe të botës... Megjithatë, qeverisen me ligjet e tyre tradicionale (Kanunin e Lek Dukagjinit), dhe në tërësi rregullin dhe disiplinën e kanë në gjak dhe bashkohen shumë si një trup i vetëm kur e lyp nevoja të luftojnë armikun...”⁶⁵

Por ngjarja krejt e veçantë me delegacionin e Meksi Bubës në Leçe të Italisë na dokumenton dhe faktin tjetër, atë të shkrimit të gjuhës shqipe, sepse ata u paraqitën me dokumentin e kërkesës për konsullin italian “... in eins lingua scripta...” (në gjuhën e tyre). Ja sa shumë i përshtatet këtij fakti paragrafi i marrë nga një studim i Rami Memushaj:

“Në shkollat që misionarët bazilianë hapën në Himarë e Dhërmi, mësimet zhvilloheshin në gjuhën greke, që ishte gjuha e kishës. Por me që nxënësit nuk e kuptonin manualin greqisht, u ndje nevoja për një tekst shqip. Për këtë, Papa Dhimitri nga Dhërmi, për të cilin mësuesi i parë në Himarë, Neofit Rodino, shkruan se “e zotëron në mënyrën më elegante gjuhën shqipe, pasi është i kësaj kombësie”, u ngarkua të përkthente “Doktrinën e krishterë”, me qëllim që të përdorej si tekst shkollor.”⁶⁶

⁶³ Halil Myrto, Revista Dyrrah N5, “Un contributo all’ analisi delle testimonianze dell’ Albanese nel Salento” (Italisht në libër) f, 27

⁶⁴ Po aty. f.27

⁶⁵ Giovanni De Camillis - f.566

⁶⁶ Rami Memushaj. “Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike”. Toena, Tiranë 2004, f.167

Por shkollë hapi Rodinoja edhe në Nivicë- Bubar edhe në Vuno ku ishte popullsia shqip-folëse dhe domosdoshmëria e të predikuarit në shqip e katekizmës ka qenë më e madhe se sa në shkollat e tjera që hapi Rodinoja në fshatrat greqisht-folëse. Sipas dokumentave që na servir Prof.Halil Myrto për këtë ngjarje delegacioni ka shkuar në Itali në vitin 1615. E ndërsa Rodinoja ka filluar misionin e tij në Himarë në vitin 1628.

Kjo vërteton një fakt interesant se gjuha shqipe ka qënë e shkruar më parë në Nivicë- Bubar dhe pikërisht, në Nivicë-Bubar Rodinoja hapi shkollë, në një fshat shumë larg, relativisht nga Dhërmiu, Himara dhe Vunoi ku ai kishte ngritur shkolla.

Përveç këtij fakti ,është dhe ai i ekzistencës së Manastirit të Kakomesë i përmendur për namin e madh dhe bibliotekën e pasur! Jo vetëm kaq po dhe ekzistenca e shumë kishave në një zone rreth e rreth fshatit e sidomos ekzistenca e kishës bizantine të Peshkëpisë e datuar në shek, e XVI –të dhe që ka qenë episkopate. Apo kisha në qendër të fshatit e datuar dhe ajo në shek. e XVI-të eqë qëndron ngjitur me shkollën e fshatit! Siç e kam përmendur në këtë studim, Neofit Rodinoja i shkroi të dyja veprat e tij në Nivicë-Bubar.

Dokumenti për delegacionin e Mexi Bubës që shkoi në Leçe, na paraqet dhe një element tjetër historik jo vetëm për fshatin Nivicë-Bubar. Ky element është vërtëtimi i praktikave tregtare të salentinëve me brigjet jugore joniane të Shqipërisë duke mos mbetur thjeshtë me praktikën e emigrimeve të shqiptarëve në krahinën e Salentos. Ata , salentinët kanë patur mardhënie tregtare të vazhdueshme me shqiptarët, gjatë gjithë mesjetës.⁶⁷

Gjithashtu mund të shpreh mendimin se në bazë të shumë dokumentave, del se Nivicë –Bubari ka qenë një epiqendër jo vetëm religjioze por bashkë me të dhe nëpërmjet saj ishte dhe një epiqendër e veprimtarive të shumta jetësore të atyre kohërave. Kjo, patjetër lidhet dhe me territorin e madh që zotëronte ky fshat, gjatë shekujve XIV-XVIII –të.

⁶⁷ Halil Myrto, Revista Dyrrah N4,vepër e cituar,f.10. “Aldila dei flussi migratori, il Salento, come terra di frontiera, ha avuto rapporti commerciali continui con l’altra sponde durante tutto medioevo tramite i porti di Brindisi,Otranto e S.Cataldo in direzione dei porti di Valona,Durazzo, Scutari e Antivari.”

Nivica në rrëzë të malit
Të qëllon topi i Sulltanit
Se ti je Kalaja e Junanit
Nivica një punë e madhe
Treqind mijë grosh livadhem
Ni(h)na, o Kakomej' e Madhe.



Hartë në kohën e pushtimit
Osman



Miniaturë ku tregohen ushtarë turq nën
drejtimin e Mahmut al Vasiti

Fenomeni i shpërnguljeve të shqiptarëve mbas vdekjes së Skëndrebeut është studjuar nga disa historianë në mënyrë disi ndryshe , ku dominon mendimi i Çabejt të madh dhe që bazohet në idenë e ekzistencës së shqiptarëve në jugun e Italisë shumë përpara Motit të Madh .

Studjuesi nga Prishtina prof. Begzad Baliu një ndjekës i prof. Çabejt shkruan:

“Kjo dyndje, në atdheun e ri , ka bashkuar dy bashkësi të krishtera ortodokse të etnikumit shqiptar, dhe dy bashkësi etnike shqiptare të ndara shekuj më parë, por që kanë ruajtur pa dallim elementët esenciale të etnisë: gjuhën, kulturën material dhe shpirtërore të tyre”⁶⁸

Dhe më tej, duke analizuar hollësisht këtë risi në studimet për historinë e shqiptarëve, po ky autor shkruan :“Pavarësisht nga kjo, Çabej, sikur edhe në shumë raste të studimeve gjuhësore, këtu gjen mbështetje te një mendim i Francesco Ribezzos, i cili për të për të njëjtin objekt studimi, që më 1942, mendonte se”vërtetimi përfundimtar qëndron në përkimin leksikor, fonetik e morfologjik midis mesapishtes dhe atij thelbi të gjuhës shqipe, që është me gjurmë indoeuropiane.”⁶⁹ Në këtë mënyrë jo vetëm nga ky autor piquet ideja për një lidhje shekullore të fiseve ilire në të dy brigjet e Adriatikut dhe të Jonit.Këtë përforcon indirekt dhe Gustav Majer tek shkruan:

“Shqiptarët jetuan në Greqi edhe para vitit 1349, kur përmenden në Peloponez.”⁷⁰ Dihet botërisht se trashëgimtarët e Skënderbeut, mbas vdekjes së tij,kryesisht u sistemuan në Italinë e Jugut. Autori Italian Carlo Padiglione në vitin 1879, në Naploi boton librin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe pasardhësit e tij”, ku në mënyrë gjenealogjike jepen familjet e pasardhësve të Skënderbeut e që jetonin kryesisht në Italinë e Jugut.⁷¹

Prandaj vizita e delegacionit shqiptar e kryesuar nga një nivociot nuk duhet parë e shkëputur nga të gjithë këto të dhëna e që kompletojnë aeralin historik shqiptar të bregdetasve nga

⁶⁸ Begzad Baliu.”Onomastikë dhe identitet”,Era, Prishtinë, 2012, f.150

⁶⁹ Begzad Baliu, Po aty, f.151-152

⁷⁰Gustav Majer,”Shqiptarët dhe gjuha e tyre” në: “Bota shqiptare” (Libër leximi për Kursin e Naltë të shkollave të Mesme),Botim I Ministrisë s’Arsimit, Tiranë,1943,f. 126

⁷¹ Carlo Padiglione,”Skënderbeu dhe pasardhësit e tij”, Ideart, Tiranë 2003

Himara e deri në Nivicë –Bubar. Prezenca e shqiptarëve ,pra, është e argumentuar me dokumenta gjatë të paktën gjashtë shekujve të fundit , jo vetëm në Leçe dhe në afërsitë e Otrantos, si në portet e Tokës së Otrantos dhe në vende të ndryshme në statusin e emigrantit resident, të vazhdueshëm, të tregtarëve e të ushtarëve me pagesë.

Studjuesi Halil Myrto gjithashtu vëren se: ” Një prezencë e mundëshme e familjeve shqiptare është gjetur edhe në brendësi të komunitetit grekfolës në Salenton e Poshtëme , me të cilët kishin të përbashkët ritin fetar bizantin , dhe herë herë edhe vendin nga kishin ardhur. Dihet se disa valë emigracioni shqiptarësh kanë arritur në Italinë Jugore pas shumë eksperiencash në emigrim të bëra në zona të ndryshme të Greqisë. Vendet e Greqisë Salentine siç e kemi thënë edhe më lart kanë mundur të ndërtojnë një strehë për ata kanë lënë vendet e “Shqipërisë Salentine” në kërkim të kushteve për të ruajtur ritin e tyre fetar.”⁷²

Gjatë studimeve që studjuesi Halil Myrto ka kryer në mardhëniet shqiptarojugore me salentinët është mbështetur midis shumë autorëve edhe tek G.Rohlfis i cili ka realizuar librin “Dizionario storico dei cognomi Salentini (Terra d’Otranto), Galatina 1982, XIII, s.v Zot. Në literaturën botërore njihet figura e Tomas Kampanelës që ishte nga Kalabria, lindur në 5 shatator 1568 dhe vdekur në 21 maj 1639.Ky është autor i veprës së mirnjohur “Qyteti i Diellit” dhe ka vepruar në Kozenca, që sipas Çabeut të madh ky qytet ka qenë një lloj kryeqendre e arbëreshëve.Në atë kohë Kalabria vuante zgjedhën e rëndë të Aragonës spanjolle që prej dy shekujsh.Eshtë pikërisht kjo zgjedhë që ,sipas historisë bëri që ky poet dhe fetar njëkohësisht , të lidhet fort me arbëreshët për të marrë frenat e pushtetit ne Kalabri.

Dihet se shekulli i 16-të ka qenë tepër i rëndësishëm jo vetëm per arbëreshët e Kalabrisë, por të të gjithë krahinave të Italisë së Jugut ku kanë jetuar arbëreshë.Mik i tij ka qenë dhe frati Dionis Poncio nga vendbanimi arbëresh i Nikastrës.⁷³


Po të paralelizosh këto ngjarje sipas datave që trajtohen

⁷² Halil Myrto , Revista Dyrrah 5, f27-28

⁷³ Moikom Zeqo,“Konceptualiteti i lirisë”,Albanopoli,2009,f29

në këtë studim për Gjergj Bastën, për Neofit Rodinon dhe Meksi Bubën, gjejmë lidhje të ndryshme që vetëm sa e qartësojnë më tej tabllonë e viteve 1589-1659 në lidhje me fshatin Nivicë Bubar. Është koha e bashkëpunimeve të mëdha midis bregdetasve me arbëreshët të cilët ishin dhe brenda fiseve të tyre e që luftonin së bashku kundër turqëve duke u kujdesur që herë të lidheshin me Papatin e herë të lidheshin me mbretërinë e Spanjës e herë herë me të dyja këto fuqi njëkohësisht. Shembulli i Tomaso Kampanelës është vetëm njeri nga faktet se si arbëreshët kanë qenë në krye të ngjarjeve tronditëse të kohës, por duhet theksuar se lufta e tyre ka qenë e pashkëputur nga bashkëpunimi me bregdetasit që nga Himara e gjer në Nivicë Bubar.

Prandaj dhe lëvizjet e Dhimitër Bastës me antarë të tjerë të kësaj zone nëpër Spanjë dhe Itali nuk janë thjeshtë veprime individuale por të bashkërenduara në kuadrin e dëbimit të pushtuesve turq. Vetë periudha kur jetoi dijetari italian Kampanela -1568-1639, përkon teorikisht me kohën e veprimit të tre personazheve që trajtohen në këtë studim.



Miniaturë: Galera turke



Hartë e gjiut të Vlorës , përgatitur nga Italia në vitet 1480, në planet për përballimin e sulmeve të mundëshme turke.



Sulltan Sulejmani i dytë

PJESA E PESTË

Ungjilli i Kakomesë

UNGJILLI I KAKOMESË

Historia e Ungjillit të Kakomesë nuk është shumë e njohur, por traditat popullore e bëjnë atë si një nga katër mrekullitë ungjillore të botës. Një i ngjashëm me të është edhe në Moskë, por jo i Lukës. Ungjilli i Kakomesë është sipas Lukës dhe konsiderohet një pasuri e veçantë jo vetëm për Nivicën por për të gjithë botën. Sot ky ungjill - spjegon Kryetari i Komunës Lukovë, Vladimir Kumi, gjithmonë sipas dokumentacioneve të siguruara, - ndodhet në Biblotekën Kombëtare të Athinës. Ky konstatim bëhet më i sigurtë se sa preçedenti i tij ku thuhej se ndodhet në një muze me emrin Banaqi po në Athinë.

Për këtë Ungjill ka histori të vërteta dhe jo gojdhëna, po edhe në se ka të tilla, ato mbështesin një të vërtetë të ekzistencës së këtij Unigjilli misterioz.

Ka kohë që në duar të ndryshme ka qarkulluar një material greqisht marrë nga Bibloteka Kombëtare greke, pjesë e një enciklopedie me karakter historiko – shoqëror ku përveç shumë teksteve këngësh për Nivicën dhe niviciotët ka disa të dhëna të veçanta dhe të pabotuara në Shqipëri pikërisht për Ungjillin e Kakomesë.

Dokumentat thonë se ai është i shkruar në pergamenë dhe i pikturuar dhe shkruar me ngjyra. Ndërsa të dhëna gojore, flasin se ka një kapak prej argjendi, të gdhendur, ose që faqja e parë mbas kapakut është e grisur. Për kapakun prej argjendi flet dhe dokumenti i përmendur në libër.

Dokumenti në greqisht thotë se në breg të Kakomesë, ungjillin e nxorri deti, bashkë me lëmyshqet dhe se aty në breg e gjeti një bari, i cili kulloste bagëtë e veta. Ç'është e vërteta, ky është dhe versioni më i përhapur dhe më i besuar ndër gjithë zonën ku ky Ungjill njihet. Por duke vërejtur

me vëmëndje disa faktorë të tjerë që kanë të bëjnë me funksionin e vetë Manastirit të Kakomesë, planimetrisë dhe strukturave të tij, mbështetur në libra të specializuar, del që në Manastrin e Kakomesë ka pas një bibliotekë të pasur e cila ishte e përdorshme nga murgjit që banonin e jetonin aty, brenda mureve të këtij Manastiri.

Në se ka patur një bibliotekë të pasur, ka patur dhe Ungjille të veçantë, ungjille që janë sjellë bashkë me librat. Pra midis tyre ka qenë dhe Ungjilli i Lukës, një Ungjill jo vetëm i veçantë por dhe çudibërës, gjëra që do të spjegohen më poshtë.


Gjithsesi edhe varianti i sjelljes, nxjerrjes së Ungjillit nga deti është i pranueshëm, në se do të sjellim ndër mend tokën ku është ndërtuar Manastiri i Kakomesë e që është tokë e shenjtë. ”

“E shenjta thërret të shenjtën.”

Përveç idesë se Manastiret ndërtohen në vende të shenjta, shenjtërinë e vendit ku është ndërtuar ky Manastir e përforcojnë edhe këto dy fakte:

1. Manastiri i Kakomesë është i tipit të fortifikuar, si rrallë në manastire e tjera. Në literaturën e deri sotme njihen manastire të fortifikuar Manastiri i Kakomesë, ai i Krorëzës dhe i Kamenos në Sarandë.
2. Manastiri i Kakomesë ndodhet “i ruajtur” nga tre Manastire të tjerë si ai i Krorëzës (Perëndim), Manastiri i Shën Vasilit (Veri) dhe Manastiri i Shën Gjergjit (Jug). Siç shihet është një trekëndësh gjeografikisht i studjuar me qëllim mbrojtjen nga të huajt të Manastirit të Kakomesë dhe të vetë Ungjillit. Është përsëri një fakt për t’u marrë në konsideratë për të evidentuar më shumë vlerën, fuqinë që posedonte ky Ungjill në krahasim me Ungjij

të kishave apo Manastireve të tjera për rreth nëpër bregdet. Fakti lidhet me mos lëvizjen e këtij Ungjilli nga Manastiri i Kakomesë, lëvizje që nënkupton largimin e tij përfundimtar nga vendi i përhershëm. Mund të sjell dy - tre shembuj të këtyre largimeve jo të Ungjijve por të ikonave me shumë vlera nga kishat shqiptare.



Një facsimile e një flete të Ungjillit të Kakomesë.

Te Ungjilli i Kakomesë besonin dhe turqit.

Myslimanët e Kurveleshit dërgonin në Kakome dhurata të shumta, sidomos bagëti, kafshë, në tufë apo veç e veç, zgjidhnin mosmarrveshjet e tyre duke u betuar mbi librin e Ungjillit duke thënë:

“Do i zgjidhim gjërat me betimin në Ungjillin e Kakomesë.”

E merrnin shpesh nëpër fshatra për shenjtërim, sidomos kur kishin sëmundje në kopetë e bagëtive.

Veprime kanunike për mbrojtjen e Ungjillit.

A. Pleqësia apo të tjerë.

Ndër shekuj kishte probleme të ndryshme dhe niviciotët për të mos u humbur ky Ungjill, merrnin masa të sigurta për t’u mbrojtur atë. Ruajtja e tij ju dha me vendim nga këto tre lloj “ Institucionesh ”:

1. Mbledhje të përgjithshme të fshatit.
2. Nga antarë të caktuar me këtë punë.
3. Nga pleqësia e fshatit.

Eshtë interesant fakti që për një kohë të caktuar këto vendime që merreshin u mbajtën me protokoll.



Kopertina prej argjendi e Ungjillit të Kakomesë.

B. Mbajtja e Ungjillit nga familje të veçanta

Familja që mbante ungjillin, nuk e linte shtëpinë asnjëherë pa roje dhe kandili ishte i ndezuar ditë e natë. Kush donte të vinte në shtëpinë për lutje, (në shtëpinë ku ruhej Ungjilli) duhej të shoqërohej nga prifti (shenjtori) dhe nga pjestarët e Këshillit të Kishës e që rrinin gjithmonë përpara. Marrja nga familja që ruante Ungjillin bëhej me rite fetare, kurse këmbanat e fshatit binin pa pushim dhe të gjithë fshatarët që gjëndeshin aty bënë kryq. I njëjti rit zhvillohej edhe kur nisej Ungjilli në një fshat tjetër.

C. Dërgimi i Ungjillit në fshatra të tjera

Për ta dërguar nga një fshat tjetër, nga kërkesa e këtij fshati duhej të shoqërohej gjatë rrugës me roje të armatosura të fshatit Nivicë dhe të fshatit që kërkonte për bekim këtë Ungjill të Shenjtë dhe pastaj merrej vendimi i fshatit.

Fiset kryesore që ruajtën Ungjillin në Nivicë- Bubar.

Fiset kryesore që ruajtën Ungjillin e Kakomesë në Nivicë ishin vëllezërit Qiriako, Vangjel dhe Anastas Papadhima, Jani Dhuli, Jorgo dhe fëmijë të vet Pilo dhe Koço Papagjika, Jorgo Gjoka, Koço Thomai, Koço Kumi, etj.

“Aventura” e Ungjillit në Korfuz.

Gjatë viteve të vështira të luftërave ballkanike , banorët e Nivicës shkuan si të dëbuar në Korfuz. Atje mori me vete Ungjillin e Kakomesë, nivicioti, roja e tij në atë periudhë, Jorgo Gjoka. Siç shkruhet në materialin greqisht të cilin po e komentoj pa ndryshuar pothuajse asgjë, në Korfuz kishte

shumë gjermanë të cilët ishin të interesuar për sende të vjetra dhe duke u njohur me Ungjillin e famshëm i ofruan rojes së Ungjillit një shumë të madhe markash gjermane. Në materiai greqisht shkruhet për 1,5 milion marka që ta blenin atë. Por roja jo vetëm që nuk pranoi por dhe u dyfishua me një roje tjetër, kështu që Ungjilli u kthye pas lufte në Nivicë-Bubar.⁷⁴

Rreziqet qeveritare për marrjen e Ungjillit nga Nivica.

Edhe pse ndodhej në fshat si pronë e Manastirit dhe vetë niviciotëve, Ungjilli ishte në vëmëndjen e qeveritarëve për ta marrë atë në “sarajet e kryeqytetit”. Ai është rrezikuar disa herë për t’u marrë me urdhër e pa urdhër, disa herë për t’u sistemuar brenda mureve të Muzeut Kombëtar.

Tre herë nën urdhërin e ministrit të brendshëm, Musa Juka guxuan xhandarët e Sarandës ta marrin Ungjillin nga Nivica por kundërshtimi i niviciotëve që tepër i fuqishëm dhe i menjëhershëm për të mos e lënë atë në duart e tyre. Rojet dhe pjestarët e Komisionit të Kishës- thotë materiali grek,- Spiro dhe Qiriako Papadhima, Vasil Muka, Koço Papagjika, Nini Dukëspiri, dhe kryeplaku i fshatit Stefan Kumi, vuajtën dënim me burg dhe në fund e dërguan vetë Ungjillin në Tiranë. Por dhe në Tiranë, Ungjilli nuk jetoi gjatë, Atje me ndërhyrjen e Mitropolitit të Gjirokastrës, të madhit Pandelimon, të Kryetarit të Kishës autoqefale shqiptare Kristo Kisi si dhe të deputetit të Delvinës dhe ministrit të drejtësisë Hiqmet Delvina, u anulua dërgimi në Tiranë dhe ai u kthye përsëri në Nivicë.

⁷⁴ Iperios, laografika – ithografika -etnografika - vepër e cituar f.243-246

Një fund i hidhur

Ungjilli deri në fund të marsit të vitit 1941 u ruajt në shtëpinë e Harrallamb Papadhimës, deri sa e morën ushtarakë të lartë grekë të brigades së III- të, që e kishin qendrën në fshatin Kudhës të Himarës. Siç vinë në kujtesë të shumë fshatarëvetë Nivicës, Shën Vasilit, Lukovës etj, kur këta ushtarakë grekë e morën ungjillin, të dy anët e rrugëve ishin të mbushura me ushtarë që ruanin ungjillin nga çdo gjë e papritur.

Thuhet se është mbajtur atje në Kudhës dhe vetë ushtarakët grekë bënë liturgji në ditët e vështira të sulmeve të italianëve, deri sa ushtria e Musolinit humbi dhe grekët e kanë çuar Ungjillin në Athinë para çlirimit të Shqipërisë nga gjermanët. Një fund i hidhur për një gjë të shenjtë, shekullor dhe famëmadh! Një ungjill ku vetë jeta e tij ngjan me jetën e shenjtëve të gjallë që janë martirizuar nga të këqinjët. Një ungjill që flet ndoshta edhe tani rënkon aty tek ndodhet, diku në raftet e Biblotekës Kombëtare greke në Athinë.

Sipas materialit që po diskutojmë, gjejmë se i paharruari doktori i vjetër Jorgo Dhuli, vëllai i Dhimitër Dhulit, ministër i autonomisë ushtarake të Epirit, e kërkoi nga dega e dorëshkrimeve të Biblotekës Kombëtare.

Një ngjarje në Manastirin e Kakomesë.

Dhimitër dhe Stefan Papadhima të Nivicës që relatohen si puntorë të fshatit Nivicë dhe murgj në Manastirin e Kakomesë në dokumentat greke, kanë treguar se në faqen e parë të Ungjillit mrekullibërës të Kakomesë ekzistonte një shënim i një dite të gushtit të vitit 1643, i cili thonte:

“Sot erdhën vizitorë në Manastir, ishin francezë, të

cilët “ dolën në tokë të thatë” poshtë Manastirit për arsye se ajo barka e tyre e quajtur **LOVER** u përplas nga valët e mëdha të detit. Francezët përveç lekëve që lanë në Manastir , dhuruan dhe një pikturë, ikonë, të Panajasë”.

Kaq thotë shënimi por faqja e parë e Ungjillit, thuhet se është grisur.Por megjithatë duhet ta besojmë si të vërtetë se thëniet për Ungjillin nga vetë fshatarët kanë qenë të vërteta ngase Ungjilli në vetevete ishte i shenjtë e për të nuk guxonte njeri të gënjente.

Ngjarja e sipërme na bën të thellohemi edhe në një konstatim sa fetar aq dhe jetësor. Gjatë diskutimeve, ideve dhe fakteve që janë trajtuar në këtë libër kanë lindur dhe ide jo vetëm përqasëse se sa në rolin e dëshmimit dokumentar historik.

Vetë Ungjilli i Kakomesë kurrë nuk shkoi në vënde të tjera veçse kur e morëm me dhunë gjatë luftës së dytë botërore dhe e çuan në Greqi,ashtu si mund të them edhe për ikonën që sollën francezët dhe nuk e morën).

Ndryshe ka ndodhur me piktura ikona të ndyshme të kishave dhe manastireve shqiptare sidomos në kohën mbas humbjes së Skëndërbeut.

Rasti më i afërt është ai i dërgimit të ikonës së Shën Marisë nga Manastiri i Kremesovës në Piqeras, nga shekulli XVII, bashkë me ungjillin e kishës ku koha e dërgesës është 1743.⁷⁵

Është një fakt tjetër i pamohueshëm sa dhe misterioz që u mbetën të krishterëve dy kisha të vogëla të paprekura; ajo e Zojës së Shkodrës dhe ajo e shënjtës Madalenë. Kurse kishat e tjera i prishën ose i kthyen në xhamija.


Dhe mrekullia ndodhi:

Sipas një tradite të shenjtë, ndër shumë të tmerruar nga

⁷⁵ Miho Gjini, “Piqerasiotët” Edlora, 2013 f. 102

frika se pas vdekjes së heroit Gjergj Kastriotit, për shqiptarët besimtarë do të ishte skllavëria më e rëndë otomane, figuronin edhe dy ushtarë të Skandërbegut : Giorgio e De Sclavis, ky i fundit i origjinës Slovene. Të vetdijshëm se të gjitha fitoret luftarake të komandantit të tyre ishin fryt i nderimit të pa kondita ndaj Zojës së Shkodrës, e deri sa ajo do të qindronte në Shqipëri do të kishte përdorë çdo mrekulli për t'iu ndalur otomanët të zaptojnë Shqipërinë, shkuan dhe iu gjuhëzuan zojës së Këshillit të Mirë për t'i kërkuar udhëzime.

Kështu, ndërsa të dy ushtarët luteshin përballë zojës së bekuar, figura e sajë nisi të largohet nga muri. E mbështjellë me një shtëllungë mjegulle e bardhë që lëshontë rreze drite u lëshua në ajër dhe u drejtua nda deti e shoqëruar nga të dy ushtarët. Me zemër plot përmallim , por dhe me shpresë të madhe në Provaninë hyjnore, Giorgio e De Sclavis fluturuan mrekullisht mbi det për ditë e netë me Zonjën e bekuar Figura kish hyrë në Genazzano, në ditën e festës së Shën Markut , mbrojtës i qytetit.Edhe sot aty ndodhet në qytetin e vogël të Genazzanos, pranë Romës.



Ikonë e Shën Marisë që është në Genazzano, Tali

A ka shpresë për rikthimin e Ungjillit të Kakomesë në Nivicë?

Eshtë një pyetje sa e dëshirueshme për t'u bërë po njëkohësisht shumë e vështirë. Kanë kaluar mbi 70 vjet që ky Ungjill nuk është në shtëpinë e tij. Manastiri i Kakomesë po restaurohet dhe ndoshta mund të kompletohet me paisjet dhe gjithçka tjetër për një gjallërim thjeshtë normal. Para se të kthehet Ungjilli në Shtëpinë e tij, le ta gjejmë e ta shohim se ku



ndodhet. Tek lexon dhe mëson peripecitë e shumta të Ungjillit, lind pyetja: E pse të mos kthehet prap Ungjilli pranë njerëzve të tij, aty në vendin e shenjtë më emrin Manastiri i Kakomesë? Ndryshe ka ndodhur me ikona të tjera shqiptare ndër shekuj, dy prej të cilave po i përmend më poshtë.

Ikone e Shën Marisë e sjellur në Villa Bodessa (Itali)

Një fakt është transferimi i ikonës së marrë nga Manastiri Kremesovës së Piqerasit në vitin 1743 në Villa Badessa , ku ndodhet edhe sot. Vetë Mjeshtri i Madh Miho Gjini në librin e tij autokton “Piqerasiotët”, titulli i të cilit të kujton romanet sagë të Europës veriore, na thotë dhe përshkruan vizitën në vitin 2012 në binjakëzimin e Komunës së Lukovës me të Roscanës :“...por do të ndalemi më tepër në këtë Festë të Madhe të traditës. Se qe një eveniment i çmuar, i gëzueshëm e i shenjtë, kushtuar Asaj Perëndie të Mirë (Odighitra), ikona e së cilës u muarr nga Manastiri Kremesovës së Piqerasit...”

Rasti i tretë që dëshiroj të parashtoj në kompletimin e idesë time, është dhe ai i fluturimit apo dërgimit të ikonës së Shën Mërisë nga pyjet e Durrësit në Forno të Italisë. Ja si shkruhet në diçiturën poshtë kësaj ikone që ndodhet sot e kësaj dite në Sanktuarin e Fornos në Itali. “Piktura e Maries, Nënë e Falenderimit dhe të Mëshirës e vitit 1400 , e realizuar mbi tavolinë, që mban në duar një kuadër ku paraqitet Shpërblimtari, i ulur dhe mban në dorën e majtë globin ,ndërsa poshtë është murgu Pjetër Bardhi. Piktura është e kishës lindore dhe e bërë shumë mirë. Ishte sjellë në Forno nga Pjetër Bardhi prej Durrësi , i cili u bë murg nga pirat që ishte dhe që ndërtoi këtë shenjtore me manastirin dhe këmbanaren”⁷⁶



⁷⁶ Dyrrah nr 4, vepër e cituar f, 36

BIBLIOGRAFIA

1. Historiku i fshatit Nivicë- Bubar, 1979, Nivicë- Bubar
2. Thoma I. Papallopoulos “Misioni i Himarës, kontribut në historinë e Epirit të Veriut (shek.17-18) Athinë, 1978 (Kuvend Shkencor për Epirin)
3. Pietro di Marco “Il Monastero di Mezzojuzo nelle storie culturale arbëreshe” [http:// www.mediaevolsophia.net/](http://www.mediaevolsophia.net/)
4. Jano Koçi “Himara” GentGrafik, Tiranë 2006
5. Francois Pouqueville . “Udhëtimi në Greqi nga Brindisi në Janinë” Tiranë, 1998
6. “Ali Tepelena (Historia e ringjalljes së Greqisë),Tiranë, 2009
7. Katherine E. Fleming “Bonaparti mysliman” Dituria , Tiranë 2003
8. Llambro Ruci “Himara-Zera e Akrokerauneve” Ombra GVG, Tiranë, 2011
9. G.Valetas. “Neofit Rodinos. Prozë demotike qipriote” Athinë , 1979
10. Dyrrah Nr 1. Botime “Pal Engjëlli” , Durrës 2001
11. Dyrrah Nr 4. Botime “ Pal Engjëlli” ,Durrës 2005
13. A. Brunello. “ Neofito Rodino, missionario e scrittore ecclesiastico Greco del sec. XVI-XVII” në: “Bulletino della Badia Greca di Grottaferrata”
14. L.Crasso “Eloggi di capitani illustri” botim i Vatikanit 1683 Romë.
15. Spiro Rusha “Himara në stuhitë e shekujve” Arbëri, Tiranë, 2001
16. “ Himara në shekuj”. Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 2004
17. Andon Baxherri. “Nivica- porta e bregdetit” Milosao, Sarandë 2010
18. Vladimir Kumi .”Ç’është dhe ç’përfaqëson Kakomeja”. [www. Himara.eu/adver/KHimariot/004.pdf](http://www.Himara.eu/adver/KHimariot/004.pdf)
19. E. Barbarich. “Un generale di cavaleria italo-albanese : Giorgio Basta”, Nuova antologia, 63, 1928.

- 20 Nicholas Pappas .”Stratioti Balcan Mercenaries in fifteenth and sixteenth Century Italy”, Sam Houston State University .
- 21.Paolo Petta .” Stradioti – soldati albanesi in Italia” sec. XV- XIX , Lecce Itali, 1996
22. Nilo Borgia. “ I monaci basiliani d’Italia in Albania” Roma. 1942
23. Dr. Kristaq Jorgji. “ Misioni i murgjëve bazilianë në Himarë” – konferenca e III panhimariote - E kaluara 2600 vjeçare, një thesar për të arthmen-.
24. Dhimitër Shuteriqi. “ Shkrimi i shqipes dhe shkollat në bregdetin himariot gjatë shek.XVII-XVIII Gazeta “Mësuesi” 23 qershor 1963 dhe 5 korrik 1963
25. Gjerak Karaiskaj. “ 5000 vjet fortifikime në Shqipëri”, Tiranë , 1981
26. Iperios.- Laografika, ithografika, etnografika.- Tomos B, Athina 1964
27. Theofan Papa “Mbishkrime të kishave në Shqipëri” Tiranë, 19
28. Pëllumb Xhufi. “Stratitët himariotë” .Konferenca III panhimariote - Ekaluara 2600 vjeçare, një thesar për të arthmen-.
29. Anton Kaçubaj.” Gjergj Basta ,gjeniu arbëresh i artit luftarak” www.Fletorjashqiptare.com
- 30.Fotaq Andrea. “Shqipëria në NATO, një kontribut me zanafillë të lashtë”,www.zemrashqiptare.net
- 31.Begzad Baliu. “Onomastikë dhe identitet” Era, Prishtinë 2012
32. Fjalori enciklopedik shqiptar .Botim i Akademisë së shkencave, Tiranë ,1985
33. Fjalori enciklopedik shqiptar.Botim i Akademisë së shkencave, Tiranë, 2008
34. Fatmir Minguli. “ Kanuni i përkitur “ Milosao, Sarandë, 2010
36. Theodhori Miho. “Gjergj Basta dhe kapedanët e Senicës” Dija, Pogradec, 20
37. Spiro Mele. “ Luani i Epirit,Ali Pasha dhe Suli “, Biris, Athinë ,1972
38. Carlo Padiglione. “ Skënderbeu dhe pasardhësit e tij”, Ideart ,Tiranë 2003
39. Rami Memushaj. “ Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnografike”, Toena,

40. Josif Papagjoni . “Shtigjeve të vendlindjes” Tiranë 2009 Tiranë, 2003
41. Priamo Bollano. “ Himara me venomet e saj”f .10, Tiranë 2010
42. Laborre de Raillicourt, Dominique. “ Basta: Comte d’Hust et du Saint- Empire”, Paris, 1968
43. Moikom Zeqo. “ Konceptualiteti i lirisë” Albanopoli, Tiranë, 2009
44. Moikom Zeqo. Himara pa eklips” Florimont, Tiranë, 2003
45. Moikom Zeqo. Niko Katalani dhe shkollat e hershme shqipe të Himarës”
- 46 Mihali Ll. Jano . Familje arbërore të njohura në vende të ndryshme të Mesdheut. Dorëshkrim.Portali “Kritika”.
47. Petro Marko. “ Njerëzit dhe gurët”
- 48 . Cirillo Karalewskij. “ La missione Greco- cattolica della Cimerra nel Epiro nel sec.XVI-XVII” ” Bessarione”- revista di studi oriental-fasc. 1, 1912
49. Gustav Majer . “Shqiptarët dhe gjuha e tyre “ në “Bota shqiptare, marrë nga Libër leximi për kursin e naltë të shkollave të mesme,Tiranë 1943.
50. Gazeta “Albania” 18 shtator 1919
51. Gazeta “ Bukevard” Durrës, 7 mars 2008. Fatmir Minguli :” Ese për babain tim”
52. Gazeta “ Nacional” 11 nëntor 2012, artikull i Ndue Ukcames, “ Kurbin e Lezhë, 380 vjet histori e Arsimit kombëtar”
- 53 .Revista “ Kalendari Kombiar”e Lumo Skëndos , f. 48, 52, Sofje 1901
- 54.Miho Gjini “Piqerasiotët” EDLORA 2013
- 55.Giovanni Scognamoglio “Nëna e Këshillit të Mirë” – Luçi sull’ est- Romë ,1994

PERMBAJTJA

Falenderim.....	fq.3
Parafjalë.....	fq.7
PJESA E PARË.....	fq.11
Nëvendtëhyrjes.....	fq.13
Dy konstatime mbi mënyrat e studimit të his....	fq.19
Një nivelim kufinjsh kohorë.....	fq.22
Intermexon.1.....	fq.28
PJESA E DYTË.....	fq. 31
Gjergj Basta – gjeneral i shquar stratiot nga Nivicë Bubari.....	fq. 33
Origjina.....	fq.34
Aktiviteti luftarak.....	fq.39
Aktiviteti teorik mbi strategjinë ushtarake.....	fq. 43
Intermexo n.2.....	fq. 45
PJESA E TRETË.....	fq. 51
Neofit Rodino.....	fq. 53
1Intermexo n.3.....	fq. 55
Jeta e Neofit Rodinos.....	fq. 56
Neofit Rodino – mësuesi i parë i Bregdetit.....	fq. 69
Intermexo n.4.....	fq. 73
PJESA E KATËRT.....	fq. 77
Meksi Buba.....	fq. 79
Rrethanat kohore të veprimtarisë së Meksi Bub....	fq. 80
Aspekte të mardhënieve të nivicjotëve më Italinë Jugore.....	fq. 83
Intermexo nr 5.....	fq. 84
PJESA E PESTË.....	fq. 93
Ungjilli i Kakomesë.....	fq. 95
Biblografia.....	fq.109